



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.621/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.09.2015 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat për renditjen e operatorëve ekonomikë në procedurën për dhënien e koncesionit/partneriteti publik privat “*Procedurë e Hapur*”, me objekt: “*Ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambjentëve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë*”, me vlerë totale 9.657.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.05.2015, nga autoriteti kontraktues, Ministria e Shëndetësisë.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Servizi Italia” s.p.a. në procedurën e mësipërme të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k.

Lagja nr. 2, Rr. “Aleksandër Goga”, Pallati mbrapa Prokurorisë, Durrës

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Shëndetësisë
*Bulevardi “Bajram Curri”, Nr. 1,
Tiranë*

Baza Ligjore: *Ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë koncesionare/partneriteti publik privat dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 43 të ligjit nr.

125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, si edhe në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktues, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e koncesionit/partneriteti publik privat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 13.2.2015 nga ana e autoritetit kontraktues, Ministria e Shëndetësisë është publikuar procedura e koncesionit/partneritetit publik privat “Procedurë e Hapur”, me objekt: “Ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambjentëve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me vlerë totale 9.657.000.000 lekë (pa TVSH)”.

II.2. Në datën 04.05.2015, autoriteti kontraktues ka zhvilluar procedurën e mësipërme të koncesionit/partneritetit publik privat.

Në procedurën koncesionare/partneriteti publik privat kanë paraqitur interes operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k.
2. “SO.GE.SI.”S.r.l.
3. “Biometric Albania”
4. “O.E.S. Distrimed”
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Investital” Llc. & “Servizi Italia” S.p.a. & “Tecnosanimed” & “U.Jet” S.r.l.

II.3. Në datën 26.05.2015 autoriteti kontraktues, me anë të shkresës nr. 1440/4 prot., ka publikuar renditjen (klasifikimin) e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë koncesionare/partneriteti publik privat, nga ku rezulton si më poshtë vijon:

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” S.p.a., vlerësuar me 73.98 pikë, i kualifikuar;
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k.& “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k., vlerësuar me 42.83 pikë, i kualifikuar;
3. “SO.GE.SI.”S.r.l. s’kualifikuar;
4. “Biometric Albania” s’kualifikuar;
5. “O.E.S. Distrimed” s’kualifikuar;

II.4. Në datën 08.06.2015, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktues, duke kundërshtuar renditjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë koncesioni/ppp, si edhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Servizi Italia” s.p.a.

II.4.1. Në ankesën dorëzuar pranë autoritetit kontraktues, operatori ekonomik ankimues ngren pretendimet si mëposhtë vijon:

[...] Njëpërmjet shkresës me nr. 1440/4 prot., datë 26.05.2015 “Kualifikimi i operatorëve ekonomikë” të autoritetit kontraktor për të cilën kemi marrë dijeni më datë 30.05.2015, nga ana e shërbimit postar, jemi informuar se shoqëria “Action Laundry” sh.p.k. është renditur në vendin e dytë pas shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a.

Në këto kushte në respekt të afatit të ankimit dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat shprehim kundërshtimet tona me renditjen duke parashtruar argumentet e mëposhtëm:

- *Së pari, referuar pikës 3 të vlerësimit, në lidhje me karakteristikat teknike të produkteve të ofruara, në bazë të dokumentit “projekti teknik” të prezantuar nga ana jonë, sqarohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë një vlerësim jo të saktë të ofertave të dy ofertuesve të kualifikuar, pasi thekson se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a. ka vendosur 18 qendra periferike për zhvillimin e shërbimit ndërsa shoqëria jonë vetëm 2 të tilla. Në të vërtetë ne kemi parashikuar përveç Qendrës së Centralizuar të Sterilizimit në QSUT, edhe 2 makro-qendra të shpërndarjes si dhe 23 qendra të tjera, praktikisht për çdo spital, që në total bëjnë 25 qendra, numër ky që matematikisht do të thotë 7 qendra më shumë, se sa ofertuesi tjetër. Ky element është i tillë që duhet të konsiderohet nga autoriteti pas rivlerësimit të pikëve për të dy ofertuesit, në përputhje me të cilin, pas llogaritjeve korrekte “Action Laundry” sh.p.k. duhet të vlerësohet me 12 pikë, ndërsa ofertuesi “Servizi Italia” me 8.64 pikë. Argumentin e sipërcituar e mbështesim në dokumentin “projekt teknik” të depozituar dhe përkatësisht në faqen 177 të këtij të fundit.*

- *Së dyti, nga renditja dhe shkaqet e vlerësuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kuptojmë që oferta jonë për numrin e seteve dhe kontenierëve të instrumentave nuk është lexuar dhe kuptuar siç duhet pasi në pikën 1 të vlerësimit, citohet se shoqëria jonë ka ofruar vetëm 1000 kontenjer/strumenta kirurgjikalë, ndërkohë që në të vërtetë ne kemi ofruar 2 katalogë ku specifikohen rreth 4000 instrumente kirurgjikalë kryesorë, të ndryshme në lartësi, kthesa, gjatësi, prerje e të tjera. Si pasojë e mos vlerësimit të drejtë të ofertës nga ana e KVO, ne nuk na është dhënë asnjë pikë, pra jemi vlerësuar me 0 pikë, ndërkohë që ofertuesit tjetër i jepen pikët maksimale, megjithëse në dokumentin e klasifikimit nuk përcaktohen pikët për të.*
Referuar përlllogaritjes aritmetikore të sasisë së instrumentave të ofruar, shoqëria jonë ka ofruar rreth 1200 instrumenta specifikë, më tepër se ofertuesi i cili është klasifikuar i pari që do të thotë se nuk duhet të ishim vlerësuar me 0 pikë, por duhet të kishim marrë pikët maksimale në këtë zë të ofertës, pikë të cilat pas rivlerësimit duhet ti hiqen ofertuesit tjetër.
- *Gjithashtu saktësojmë se oferta jonë jep mundësinë e kompozimit të seteve kirurgjikalë në bazë të preferencave të vetë mjekëve kirurgë, praktikisht në miliona kombinime. Në përfundim, duke marrë shkas nga pika 2 e vlerësimit dhe gjendja faktike e ofertave të të dy ofertuesve, ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. ka ofruar në total 96,234 instrumenta duke u vlerësuar nga KVO me 14 pikë, ndërkohë që ne kemi ofruar rreth 100,000 instrumenta kirurgjikalë sipas llojit dhe metodologjisë dhe jemi vlerësuar me 0 pikë, gjë që duhet të ishte vlerësuar në kah të kundërt, përkatësisht 14 pikë për ne dhe 0 pikë për ofertuesin “Servizi Italia” s.p.a.*
- *Pretendimin tonë e bazojmë në dokumentacionin e paraqitur në procedurë ku skedat/listat jepen të ndarë për çdo kategori ndërhyrje kirurgjikale, gjë e cila është shumë e thjeshtë për t’u verifikuar pas një kontrolli më të kujdësshëm nga ana e KVO-së.*
- *Së treti, ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. ka ofruar një 2934 sete kirurgjikale rezervë, ndërsa ne, kemi ofruar 10 % - 12 % të instrumenteve si fond rezervë, në bazë të ndërhyrjeve kirurgjikale që zhvillohen gjatë harkut kohor të një viti, që siç është parashtruar nga autoriteti kontraktor janë rreth 50.000 ndërhyrje kirurgjikale. Me anë të përlllogaritjes së thjesht matematikore ne kemi ofruar 5.000 – 6.000 sete kirurgjikale shtesë në vit. Pra rreth 2-3 herë më shumë se ofertuesi i vlerësuar i pari. Ajo çka ne mendojmë se duhet të ishte vlerësuar nga KVO përveç faktit që ne kalojmë dyfishin e sasisë së rezervës së ofruar nga ofertuesi tjetër, është fakti se oferta jonë është mbi bazë të ndërhyrjeve që do të realizohen duke ofruar mbulim të plotë të tyre edhe me rezervë. Në rast të shtimit të ndërhyrjeve mbi mesataren e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor (raste fatkeqësish natyrore apo njerëzore), ne i kemi ofruar autoritetit mbulimin e sigurtë të tyre, ndërkohë që ofertuesi tjetër,*

ofron një numër minimalisht dyfish më të vogël se ne dhe një numër fiks aspak variabël në rast nevojë të autoritetit.

Vlerësimi i KVO-së duke i dhënë ofertuesit tjetër 14 pikë dhe ne 0 pikë, megjithëse faktet flasin për epërsi të ofertës sonë në këtë zë, mendojmë që nuk është aspak i drejtë dhe ligjor dhe është shkak për rivlerësim. Sipas një llogarie të bërë nga ana jonë, vlerësimi real duhet të ishte 14 pikë për “Action Laundry” sh.p.k. dheh 8.22 pikë për ofertuesin e klasifikuar të parin.

- Së katërti, në lidhje me pikën 4 të vlerësimit dhe pikërisht kohën e vënies në shfrytëzim të objektit koncesionar është bërë një vlerësim jo i drejtë i ofertës nga ana e KVO-së, pasi shoqëria jonë ka ofruar fillimin e kontratës (vënien në punë), brenda një harku kohor nga 23 ditë kalendarike deri në 1 muaj. Komisioni gabimisht/çuditërisht e ka interpretuar këtë afat në 50 ditë ndërkohë që oferta tjetër është me afat 60 ditë. Në bazë të këtij gabimi Komisioni ne na ka vlerësuar me 6 pikë dhe ofertuesin tjetër me 4.98 pikë. Duke pasur parasysh se oferta jonë është maksimumi 30 ditë, pra gjysma e afatit që ofron ofertuesi i klasifikuar i pari, mendojmë se pas ribërjes së vlerësimit shoqëria jonë duhet të vlerësohet me 6 pikë ndërsa ofertuesi tjetër vetëm 3 pikë, duke i ulur atij 1.98 pikë nga pikët që ka marrë.
- Së pesti, për mendimin tonë edhe më e rëndësishmja, ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk duhet të ishte kualifikuar nga ana e KVO-së, duke përjashtuar nga gara për arsyet e mëposhtme:
 1. Referuar pikës 3 të shtojcës 9 “Kriteret e përgjithshme për kualifikim”, ofertuesi duhet të dorëzonte pranë autoritetit vërtetimin QKR (vërtetim nga regjistri tregtar), të cilin vërtet e ka depozituar, por objekti i koncesionit nuk është i parashikuar në objektin e aktivitetit të kësaj shoqërie (referuar ekstraktit të shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a.), gjë që është shkak për skualifikim. (kualifikimi e bën procedurën të bazohet mbi një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm).
 2. Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së instrumenteve kirurgjikalë.
 3. Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së makinerive/autoklavave për sterilizimin e materialeve.
 4. Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e pastrimit, dezinfektimit të ambienteve të qendrës së sterilizimit.
 5. Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk është i lencuar për të ofruar shërbimet e parashtruara në këtë koncesion në shtetet extra/EU.

Të gjitha parashtrimet e sipërcituara, jo vetëm që duhet të merren parasysh nga autoriteti kontraktor i cili të bëjë rivlerësim të procedurës dhe klasifikimit (në kushtet kur ligjërisht kishte edhe të gjitha mundësitë që për çdo paqartësi të kontaktonte ofertuesin, veprim të cilin nuk e ka kryer), por duhet të konsiderohen edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik, e cila nuk duhet të botojë njoftimin e fituesit në buletin, pasi vlerësimi nuk është aspak ligjor e objektiv dhe mbi të gjitha është diskriminues për shoqërinë tonë.

II.5 Në datën 10.06.2015 autoriteti kontraktues, me anë të shkresës nr. 1440/12 prot., i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën e tij, me argumentimin se ankesa është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik.

II.6. Në datën 22.06.2015 operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar si më poshtë vijon:

I

Së pari, nga KVO-ja dhe autoriteti kontraktor është bërë gabim përlllogaritja e pikëve në lidhje me çmimin e ofruar nga operatorët ekonomikë, për faktin se janë akorduar pikët pa marrë parasysh peshën specifike që ka secili nga zërat e shërbimeve të kërkuar.

Konkretisht në DST është kërkuar që të ofrohet çmimi për kryerjen e shërbimeve të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumentave kirurgjikalë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, në zërat si më poshtë:

- 1. Çmimi për set instrumentash për 15.000 ndërhyrje me intensitet të lartë, vlerësimi 7 pikë.*
- 2. Çmimi për set instrumentash për 10.000 ndërhyrje me intensitet të mesëm, vlerësimi 7 pikë.*
- 3. Çmimi për set instrumentash për 15.000 ndërhyrje me intensitet të ulët, vlerësimi 7 pikë.*
- 4. Çmimi për set instrumentash të sterilizuar për pacientët ambulator për 5.000 ndërhyrje, vlerësimi 7 pikë.*
- 5. Çmimi për sterilizim në temperaturë të ulët për 5.000 ndërhyrje, vlerësimi 4 pikë.*

Bazuar në çmimet e ofruara nga shoqëria jonë “Action Laundry” sh.p.k. dhe shoqëria “Servizi Italia” s.p.a., nga KVO-ja ka bërë përlllogaritje të gabuara duke u nisur nga çmimi për njësi dhe jo nga vlera totale duke vlerësuar:

- Shoqërinë “Action Laundry” sh.p.k. me 25.28 pikë,*
- Shoqërinë “Servizi Italia” s.p.a. me 26.02 pikë.*

Në fakt vlerësimi duhet të bëhet mbi bazën e vlerave për të gjitha ndërhyrjet dhe sterilizimet e kërkuara prandaj ne po paraqesim vlerësimin e saktë si më poshtë:

Oferta e shoqërisë “Action Laundry” sh.p.k. vlerësohet:

- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të lartë, $25300 \times 15000 = 379.500.000$ lekë.*
- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje intensitet i mesëm, $16950 \times 10000 = 169.500.000$ lekë.*
- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të ulët, $11050 \times 15000 = 165.750.000$ lekë.*
- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të ulët, $6800 \times 5000 = 34.000.000$ lekë.*

- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të ulët, 950x5000 = 4.750.000 lekë.

Totali = 753.500.000 lekë që nisur nga vlera më e ulët e ofertuesve vlerësohet me 32 pikë.

Oferta e shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a. vlerësohet:

- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të lartë, 37700x15000 = 565.500.000 lekë.
- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje intensitet i mesëm, 23300x10000 = 223.000.000 lekë.
- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të ulët, 13900x15000 = 208.500.000 lekë.
- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të ulët, 6800x5000 = 1.330.000 lekë.
- Vlera për set instrumentash për ndërhyrje me intensitet të ulët, 1090x5000 = 5.450.000 lekë.

Totali = 1.003.780.000 lekë që nisur nga kjo vlera përlllogaritet me 24 pikë.

Bazuar në këto përlllogaritje të sakta të sipërcituara është e qartë se KVO ka gabuar në vlerësimin me pikë të ofertës tonë e cila rezulton të jetë oferta fituese e procedurës sepse në finale shoqëria jonë për të njëjtin shërbim të kërkuar nga autoriteti kontraktor kemi ofruar vlerën 753.500.000 lekë, ndërkohë që shoqëria “Servizi Italia” s.p.a. ka ofruar vlerën 1.003.780.000 lekë.

II.

Së dyti, edhe vlerësimi i KVO për pikat 1 Numri i Seteve, 2 Numri i Instrumentave, 3 Qendrat Periferike, 4 Kohën e Vënies në Shfrytëzim dhe 5 Impakti Mjedisor, konstatojmë se është tepër i gabuar për sa vijon:

Së dyti, lidhur me numrin e seteve dhe numrin e instrumentave në mënyrë absurde ne jemi vlerësuar me 0 (zero) pikë për numrin e seteve dhe me 0 (zero) pikë për numrin e instrumentave. Në bazë të dokumentit “projekti teknik” posaçërisht në faqen 128 dhe 180, si edhe në katalogun e instrumentave të prezantuar nga ne, janë dokumentuar të gjitha setet dhe instrumentat e kërkuara. Projekti jonë është unik dhe ka të detajuara të gjitha hapat për realizimin e kontratës ku demonstrojmë se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dhëna në dokumentat standarte të procedurës në lidhje me numrin e seteve dhe numrin e instrumentave.

Nga renditja dhe shkaqet e vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kuptojmë që oferta jonë për numrin e seteve dhe kontenjerëve të instrumentave, nuk është lexuar dhe kuptuar siç duhet, pasi në pikën 1 të vlerësimit citohet se shoqëria jonë ka ofruar vetëm 1000 kontenjer/stumenta kirurgjikale, ndërkohë që në të vërtetë ne kemi ofruar 2 katalogë ku specifikohen rreth 4000 instrumente kirurgjikale kryesorë, të ndryshme në lartësi, kthesa, gjatësi, prerje e të tjera. Si pasojë e mos vlerësimit të drejtë të ofertës nga ana e KVO, ne

nuk na është dhënë asnjë pikë, pra jemi vlerësuar me 0 pikë, ndërkohë që ofertuesit tjetër i jepen pikët maksimale, megjithëse në dokumentin e klasifikimit nuk përcaktohen pikët për të. Referuar përlllogaritjes aritmetikore të sasisë së instrumentave të ofruar, shoqëria jonë ka ofruar rreth 1200 instrumenta specifike, më tepër se ofertuesi i cili është klasifikuar i pari që do të thotë se nuk duhet të ishim vlerësuar me 0 pikë, por duhet të kishim marrë pikët maksimale në këtë zë të ofertës, pikë të cilat pas rivlerësimit duhet ti hiqen ofertuesit tjetër. Gjithashtu saktësojmë se oferta jonë jep mundësinë e kompozimit të seteve kirurgjikalë në bazë të preferencave të vetë mjekëve kirurgë, praktikisht në miliona kombinime. Në përfundim, duke marrë shkas nga pika 2 e vlerësimit dhe gjendja faktike e ofertave të të dy ofertuesve, ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. ka ofruar në total 96,234 instrumenta duke u vlerësuar nga KVO me 14 pikë, ndërkohë që ne kemi ofruar rreth 100,000 instrumenta kirurgjikalë sipas llojit dhe metodologjisë dhe jemi vlerësuar me 0 pikë, gjë që duhet të ishte vlerësuar në kah të kundërt, përkatësisht 14 pikë për ne dhe 0 pikë për ofertuesin “Servizi Italia” s.p.a.

Pretendimin tonë e bazojmë në dokumentacionin e paraqitur në procedurë ku skedat/listat jepen të ndarë për çdo kategori ndërhyrje kirurgjikale, gjë e cila është shumë e thjeshtë për t’u verifikuar pas një kontrolli më të kujdesshëm nga ana e KVO-së.

Pretendimin tonë e bazojmë në dokumentacionin e paraqitur në procedurë ku skedat/listat jepen të ndarë për çdo kategori ndërhyrje kirurgjikale, gjë e cila është shumë e thjeshtë për t’u verifikuar pas një kontrolli më të kujdesshëm nga ana e KVO-së.

Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. ka ofruar një 2934 sete kirurgjikale rezervë, ndërsa ne, kemi ofruar 10 % - 12 % të instrumenteve si fond rezervë, në bazë të ndërhyrjeve kirurgjikale që zhvillohen gjatë harkut kohor të një viti, që siç është parashtruar nga autoriteti kontraktor janë rreth 50.000 ndërhyrje kirurgjikale. Me anë të përlllogaritjes së thjesht matematikore ne kemi ofruar 5.000 – 6.000 sete kirurgjikale shtesë në vit. Pra rreth 2-3 herë më shumë se ofertuesi i vlerësuar i pari. Ajo çka ne mendojmë se duhet të ishte vlerësuar nga KVO përveç faktit që ne kalojmë dyfishin e sasisë së rezervës së ofruar nga ofertuesi tjetër, është fakti se oferta jonë është mbi bazë të ndërhyrjeve që do të realizohen duke ofruar mbulim të plotë të tyre edhe me rezervë. Në rast të shtimit të ndërhyrjeve mbi mesataren e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor (raste fatkeqësish natyrore apo njerëzore), ne i kemi ofruar autoritetit mbulimin e sigurtë të tyre, ndërkohë që ofertuesi tjetër, ofron një numër minimalisht dyfish më të vogël se ne dhe një numër fiks aspak variabël në rast nevojë të autoritetit.

Vlerësimi i KVO-së duke i dhënë ofertuesit tjetër 14 pikë dhe ne 0 pikë, megjithëse faktet flasin për epërsi të ofertës sonë në këtë zë, mendojmë që nuk është aspak i drejtë dhe ligjor dhe është shkak për rivlerësim. Sipas një llogarie të bërë nga ana jonë, vlerësimi real duhet të ishte 14 pikë për “Action Laundry” sh.p.k. dhe 8.22 pikë për ofertuesin e klasifikuar të parin.

III.

Së treti, lidhur me Qendrat Periferike, KVO në mënyrë të gabuar ka interpretuar “projekti teknik” të prezantuar nga ana jonë duke supozuar se kemi paraqitur vetëm 2 qendra

periferike. Referuar pikës 3 të vlerësimit, në lidhje me karakteristikat teknike të produkteve të ofruara, në bazë të dokumentit “projekti teknik” të prezantuar nga ana jonë, sqarojmë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë një vlerësim jo të saktë të ofertave të dy ofertuesve të kualifikuar, pasi thekson se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a. ka vendosur 18 qendra periferike për zhvillimin e shërbimit ndërsa shoqëria jonë vetëm 2 të tilla. Në të vërtetë ne kemi parashikuar përveç Qendrës së Centralizuar të Sterilizimit në QSUT, edhe 2 makro-qendra të shpërndarjes të cilat kryejnë të njëjtin funksion me Qendrën e Centralizuar të Sterilizimit në QSUT (prodhimin e seteve kirurgjikale). Theksojmë se në varësi të këtyre 2 makro qendrave janë 23 qendra të tjera periferike, praktikisht për çdo spital të cilat shërbejnë për zhvillimin e shërbimit siç edhe specifikohet dhe kërkohet nga autoriteti kontraktor. Pra siç shihet, interpretimi i KVO se shoqëria jonë ka vendosur vetëm 2 qendra periferike është i gabuar pasi siç edhe cituam më sipër shoqëria jonë ka vendosur 2 makro – qendra (së bashku me atë të ndodhur pranë QSUT 3), të cilat shërbejnë për prodhimin e seteve kirurgjikale, makroqendra këto të cilat kanë në varësi 28 qendra periferike të cilat shërbejnë për zhvillimin e shërbimit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, çka do të thotë se në total bëjnë 28 qendra, numër ky që matematikisht do të thotë 5 qendra më shumë se sa ofertuesi tjetër.

Ky element është i tillë që duhet të konsiderohet nga autoriteti pas rivlerësimit të pikëve për të dy ofertuesit, në përputhje me të cilin, pas llogaritjeve korrekte “Action Laundry” sh.p.k. duhet të vlerësohet me 12 pikë, ndërsa ofertuesi “Servizi Italia” me 8.64 pikë. Argumentin e sipërcituar e mbështesim në dokumentin “projekt teknik” të depozituar dhe përkatësisht në faqen 177 të këtij të fundit.

IV.

Së katërti, në lidhje me kohën e vënies në shfrytëzim KVO përsëri ka bërë përllogaritje të gabuara.

Në DST kërkohet që projekti të zbatohet brenda afatit 60 ditor dhe në këtë kuptim ofertuesit që respektojnë afatin 60 ditor duhet të vlerësohen me pikët maksimale prej 6 pikë. Në fakt në mënyrë të gabuar KVO-ja na ka vlerësuar ne me 6 pikë dhe ka zbatuar koeficientin për ofertuesin tjetër duke e vlerësuar në mënyrë të gabuar me 4.98 pikë.

V.

Së pesti, për mendimin tonë edhe më e rëndësishmja, ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk duhet të ishte kualifikuar nga ana e KVO-së, duke përjashtuar nga gara për arsyet e mëposhtme:

- Referuar pikës 3 të shtojcës 9 “Kriteret e përgjithshme për kualifikim”, ofertuesi duhet të dorëzonte pranë autoritetit vërtetimin QKR (vërtetim nga regjistri tregtar), të cilin vërtet e ka depozituar, por objekti i koncesionit nuk është i parashikuar në objektin e aktivitetit të kësaj shoqërie (referuar ekstraktit të shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a.), gjë që është shkak për skualifikim. (kualifikimi e bën procedurën të bazohet mbi një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm).

- Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së instrumenteve kirurgjikalë.
- Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së makinerive/autoklavave për sterilizimin e materialeve.
- Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e pastrimit, dezinfektimit të ambienteve të qendrës së sterilizimit.
- Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk është i lejuar për të ofruar shërbimet e parashtruara në këtë konkursion në shtetet extra/EU.
- Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk disponon licencën e kërkuar për trajtimin e mbetjeve spitalore.

Nisur nga vlerësim i gabuar i autoritetit kontraktor në zbatim të legjislacionit në fuqi për konkursionet dhe partneritetin publik privat, në datën 05.06.2015 nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a. dorëzuar postimin zyrtar të ankimit përkatës pranë Autoritetit kontraktor. Më tej në datën 11.06.2015 na është komunikuar vendimi nr. 1440/12, datë 10.06.2015 i autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilit informohemi se autoriteti kontraktor nuk e ka shqyrtuar ankimin tonë me pretendimin se ky ankim është bërë jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në ligj. Shoqëria jonë jo vetëm që e ka dorëzuar ankimin brenda afatit ligjor, por e ka dorëzuar këtë ankim edhe nëpërmjet rrugës së vetme zyrtare të njohur nga ligji për komunikimin e shkresave dhe akteve zyrtare, atë të postës zyrtare.

[...]

Në këto kushte për sa më sipër kërkojmë nga ana e KPP:

1. Të pezullohet procedura e mëtejshme e konkursionit/ppp me objekt “Ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambjenteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë”, [...] deri në shqyrtimin e plotë të ankesës tonë nga ana e këtij komisioni.
2. Të skualifikohet “Servizi Italia” s.p.a. e cila nuk plotëson kriteret kualifikuese parashikuar më sipër dhe në DST në shërbimin e transportit/lëvizjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore (licenca e leje) për tu bërë në shtetet Extra UE.
3. Të bëhet rivlerësimi i pikëve të dhënë në mënyrë të gabuar nga ana e autoritetit kontraktor ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e sipërcituar. Për këtë duhet të konsultohen ofertat me ekspertë të pavarur të kësaj fushe.
4. Të anulohet vendimi i KVO dhe të shpallet fituese shoqëria “Action Laundry” sh.p.k. në mënyrë përfundimtare që plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DST.

II.7. Në datën 09.07.2015, autoriteti kontraktues, me anë të shkresës nr. 1440/18 prot., datë 08.07.2015, ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 1140/2, datë 02.07.2015 të Komisionit të Prokurimit Publik, për pezullimin e procedurës dhe dërgimin e informacionit dhe

dokumentacionit të nevojshëm për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë procedurë koncesioni/ppp.

II.8. Në datën 14.07.2015, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin KPP 1248/2015 ka vendosur mospranimin e kërkesës së autoritetit kontraktues për rishikimin e vendimit të pezullimit në lidhje me procedurën koncensionare objekt shqyrtimi.

II.9. Në datën 22.07.2015, nëpërmjet shkresës nr. 1440/20 prot., datë 22.07.2015, me objekt *“Dërgim informacioni”*, autoriteti kontraktues ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin dhe dokumentacionin për procedurën e koncesionit/ppp me objekt *“Ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambjenteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë”*.

II.10. Në datën 23.07.2015, me anë të shkresës nr. 1248/2 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, meqenëse dokumentacioni i sjellë me shkresën nr. 1440/20 prot., datë 22.07.2015 nga autoriteti kontraktues nuk ishte i plotë sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e pezullimit, i ka rikërkuar këtij të fundit paraqitjen dhe depozitimin e plotë të dokumentacionit në lidhje me procedurën e mësipërme të dhënies së koncesionit/ppp.

II.11. Në datën 29.07.2015 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1248/3, shkresa e autoritetit kontraktues nr. 1440/22 prot., datë 29.07.2015, me objekt: *“Shkresë përcjellëse”*, me anë të të cilës depozitohet informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit/ppp me objekt: *“Ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambjenteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë”*.

II.11.1. Autoriteti kontraktues sëbashku me dërgimin e të dhënave mbi procedurën e dhënies së koncesionit/ppp objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ka paraqitur edhe parashtrime me shkrim në lidhje me themelin e ankimit si më poshtë vijon:

[...] Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur konstatojmë se operatorët ekonomikë Servizi Italia dhe Action Laundry kanë përmbushur kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, kërkesat ligjore, teknike dhe financiare për kualifikim, të cilat janë të publikuara në dokumentat standarte të koncensionit.

Referuar metodologjisë së vlerësimit të publikuar në dokumentat standarte të koncensionit Komisioni i Dhënies së Koncesionit i ka vlerësuar ofertat e këtyre operatorëve duke renditur në vend të parë OE Servizi Italia dhe në vend të dytë OE Action Laundry.

Me shkresën nr. 1440/4, datë 26.05.2015, autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë ka publikuar renditjen (klasifikimin) e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Më datë 08.06.2015 me shkresën nr. 1441/9 prot., operatori ekonomik Action Laundry ka paraqitur ankesë në lidhje me klasifikimin e operatorëve ekonomikë [...].

Me shkresën nr. 1440/12 prot., datë 10.06.2015, titullari i autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje duke i sqaruar se ankimi i bërë nga ana e tij nuk do të shqyrtohej në themel pasi ky ankim ishte jashtë afateve të përcaktuara nga ligji për prokurimet publike.

Autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë është vënë në dijeni për ankesën e operatorit ekonomik Action Laundry drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik në datë 06.07.2015, nëpërmjet vendimin nr. 1140/2, datë 02.07.2015, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Sjellim në vëmendjen tuaj faktin se operatori ekonomik Action Laundry nuk ka bërë njoftimin edhe të autoritetit kontraktor duke anashkalluar detyrimin ligjor, në bazë të pikës 6 të nenit 63 të LPP, VKM nr. 469, dt 16.06.2010[...]. Në bazë sa më sipër operatori ekonomik Action Laundry ka pasur detyrimin ligjor që një kopje të ankesës me të cilën ka investuar institucionin tuaj ta dërgonte njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor në Ministrinë e Shëndetësisë gjë që nuk e ka bërë asnjëherë sot e kësaj dite. Për këtë arsye në datë 23.06.2015 Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar operatorin ekonomik Servizi Italia se është shpallur fitues dhe e ka ftuar të fillojë procedurat e lidhjes së kontratës. Po ashtu është njoftuar edhe Agjencia e Prokurimit për të bërë njoftimin e shpalljes së fituesit.

[...]

Në lidhje me kërkesën e ankuesit Action Laundry për s'kualifikimin e operatorit ekonomik Servizi Italia me pretendimin se nuk disponon licencat e kërkuara sipas objektit të procedurës së sipërpërmendur të koncensionit, Komisioni i dhënies së Koncensionit vëren se ky bashkim i përkohshëm i operatorëve i përfaqësuar nga Servizi Italia i disponon të gjitha licencat e kërkuara në dokumentat standarte të koncensionit si dhe ka objekt të veprimtarisë së tij objektin e koncensionit [...], fakt ky i cili vërtetohet edhe nga ekstrakti i lëshuar nga dhoma tregtare e Parmës, bashkëngjitur ankesës së bashkimit të përkohshëm të operatorëve i përfaqësuar nga operatori ekonomik Action Laundry duke kundërthënë kështu pretendimin e operatorit ekonomik Action Laundry për mospasjen e licencës nga ana e Servizi Italia.

Në lidhje me kontestimet e pikës 1, në faqen 177 të projektit teknik rezulton i konfirmuar gjykimi i Komisionit Vlerësues duke qenë se bashkimi i operatorëve ekonomikë i kryesuar nga Action Laundry ka parashikuar krijimin e vetëm 2 “qendrave periferike autonome” si qendra të back up dhe nuk rezulton e specifikuar në projektin e paraqitur asnjë vlerë numerike për qendra të tjera periferike.

Veçanërisht për çdo qendër periferike dokumenti standart i tenderit, shtojca 12, Specifikimet teknike, pika 1, kërkon furnizimin dhe instalimin e një autoklavi me 4 njësi, 1 termodizinfektant me prelarje dhe dekontaminim termokimik, 1 pajisje me mbyllje hermetike të qeseve mjekësore. Këto investime të detyrueshme nuk rezultojnë në shtojcat e projektit teknik (shtojca 4 e projektit) dhe në planin ekonomik dhe financiar (shtojca 3 e projektit) e prezantuar nga Action Laundry.

Përsa i përket pikës 2, të kontestimit, në kriteret e vlerësimit të projektit teknik rezulton të jenë kryesore dy parametra sasior/kuantitativ “objektiv”. Parametri i parë i vlerësimit (14 pikë) është numri i seteve kirurgjikale që ripërdoren dhe që janë në dispozicion për gjatë gjithë kontratës së koncensionit. Këto sete janë prezantuar në linjë të përgjithshme nga enti kontraktues në shtojcën 22 të tenderit “Lista me instrumentat kirurgjikal” i vetmi referim numerik që komisioni ka pasur mundësi të verifikojë rezulton në pikën a.3 të Business Plan të konkuresit Action Laundry me një investim për instrumentarin kirurgjikal që është i barabartë me 224.448.000 lekë. Ofertuesi Action Laundry duhej të kishte prezantuar në projekt një listë me sete kirurgjikale për çdo disiplinë në konformitet me përcaktimet e dhëna nga Enti kontraktor. Në analizën e ofertës së Action Laundry nuk rezultojnë të dhëna numerike të përcaktuara nga tipologjia e seteve të instrumentave kirurgjikalë që ripërdoren dhe konfigurimi i vetë seteve. Shoqëria Action Laundry është limituar në paraqitjen e katalogëve ilustrativ të një prodhuesi pakistanez (Surgicon).

Nuk rezulton në asnjë kapitull që projekti teknik të ketë referimet dhe konfigurimin e seteve dhe numri ose tipi i seteve të parashikuara në shtojcën 22. Ky element i pavendosmërisë krijon një kusht që nuk mund të përcaktohen as parametrat e dytë (numri total i instrumentave kirurgjikal që do jenë në shërbim të entit kontraktor). Me këtë qëllim Komisioni i Vlerësimit nuk ka gjetur asnjë përgjigje “indirekte” nga analiza e planit të investimeve për instrumentat kirurgjikalë. Pretendimi i konkurrentit Action Laundry, në ankimin e tij se janë ofruar dy katalogë ku specifikohet rreth 4000 instrumente, tregon qartë se së pari bashkimi i përkohshëm i kryesuar nga Action Laundry nuk ka kuptuar që duhet të paraqesë setet e personalizuar (me instrumentat përkatës sipas çdo procedure kirurgjikale) duke mos lënë vend për evazivitet dhe së dyti, nuk mund të pretendojë operatori që KVO të numërojë vetë se sa instrumenta janë në katalogët e ofruar nga operatori dhe si ata kombinohen në sete të personalizuar, pasi në asnjë vend nuk përmendet numri i instrumentave nga ky operator. Po ashtu duke qenë se katalogët janë ilustrativ çdokush mund të ofrojë katalogë on-line, por thelbi i kësaj procedure të bërë nga Ministria e Shëndetësisë është që të gjenden operatorë të specializuar për të ofruar katalogët e vet dhe ofertën e vet në lidhje me setin e personalizuar të instrumentave, gjë që operatori ekonomik Servizi Italia e ka bërë dhe të personalizuar si ofertën e vet, me firmat dhe vulat përkatëse. (ref. Projekti teknik i OE Servizi Italia, SET Configuration). OE Action Laundry nuk e ka plotësuar këtë kërkesë.

Për më tepër që setet ambulatore të ofruara nga Action Laundry janë njëpërdorimëshe dhe si të tilla ndikojnë në një nga kriteret e rëndësishme atë të riinvestimit në instrumenta dhe teknologji duke mos ofruar instrumenta shumëpërdorimëshe, të cilat në fund të përiudhës koncensionare do t'i ngelen autoritetit kontraktor.

Edhe në kontratën e përkohshme të bashkëpunimit të lidhur me 03.05.2015, faqe 2, asnjë nga shoqëritë nuk merr përsipër ofrimin e instrumentave kirurgjikalë shumëpërdorimëshe.

Duke dashur të interpretohet teza e papranueshmërisë e bërë nga Action Laundry që thotë në vija të përgjithshme që do të furnizojë një set kirurgjikal që do të ripërdoret në volum prej 10/12% të volumit vjetor të aktivitetit kirurgjikal të stimuluar (50.000 ndërhyrje) do të rezultonte një investim me 24.448.000 lekë që do kishin krijuar 6000 sete kirurgjikale. Në

këtë rast investimi mesatar për çdo set të ripërdorur (konteniere dhe instrumenta kirurgjikalë) duhet të ishte deri 37.408 lekë (271 eur/set). Një paradoks i tillë sjell në përfundimin që është e paqëndrueshme vërejtja e konkurrentit Action Laundry pasi çmimi mesatar i tregut për setet e instrumentave kirurgjikalë të ripërdorshëm me cilësi mesatare është 10 herë më i madh se përlllogaritja matematikore përse i përket referimit në projekt dhe vlerësimet e bëra nga shoqëria Action Laundry.

Përse i përket kontestimit në kohën e zbatimit të projektit komisioni ka vlerësuar në mënyrë shumë të matur diskordancën e të dhënave në faqen 2 të kapitullit 1 të projektit teknik dhe grafikun funksional të zbatimit në faqen 11 të kapitullit 2 të projektit teknik, ku vërehet që “faktori kohë” për aktivizimin e shërbimit pranë QSUT Tiranë është 50 ditë.

Përse i përket pikës 5, Enti Kontraktor njofton që shoqëria Action Laundry nuk disponon aq shumë të dhëna dhe informacione përse i përket kushteve të kapacitetit teknik të bashkimit të përkohshëm të shoqërive që i referohen Servizi Italia, ku është parë me vëmendje nga KVO se ky bashkim i përkohshëm i shoqërive i plotëson të gjitha kriteret ligjore, teknike dhe financiare për të qenë pjesë e garës.

Për më tepër bashkimi i përkohshëm i kryesuar nga Action Laundry nuk ka arritur të interpretojë sensin e projektit për furnizimin e setit të instrumentave kirurgjikalë që përfaqëson pjesën më të rëndësishme të shërbimit dhe investimit. Bashkimi i përkohshëm i kryesuar nga Action Laundry i ka kushtuar shumë vëmendje sistemit informatik dhe pjesës së trajtimit të mbetjeve. Sterilizimi që ajo ofron kryehet me metodologjinë e autoklavit me avull dhe jo me sterilizim në temperatura të ulëta. Sterilizimi me temperatura të ulëta sjell avantazh më të madh në cilësinë e sterilizimit. [...]”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktues

Arsyeton

III.1. Lidhur mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi kryerjen e rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të ofertës ekonomike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat me argumentet se “[...] Nga KVO-ja dhe autoriteti kontraktor është bërë gabim përlllogaritja e pikëve në lidhje me

çmimin e ofruar nga operatorët ekonomikë, për faktin se janë akorduar pikët pa marrë parasysh peshën specifike që ka secili nga zërat e shërbimeve të kërkuar. Konkretisht në DST është kërkuar që të ofrohet çmimi për kryerjen e shërbimeve të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumentave kirurgjikalë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pretendimi i mësipërm i ngritur nga pala ankimuese është një pretendim i ngritur vetëm në ankesën dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe për të nuk është shteruar ankimi në fazë të parë pranë autoritetit kontraktues.

III.1.1. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit. Në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ky i fundit nuk është ankuar lidhur me pretendimin e mësipërm pranë autoritetit kontraktues.

III.1.2. Në nenin 43 “*Procedura administrative dhe hetimi administrativ*” i ligjit 125/2013 datë 25.04.2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë procedurat administrative të shqyrtimit dhe procedurat e hetimit administrativ, zbatohen në përputhje me rrethanat për dhënien e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të parashikuara me këtë ligj. Në nenin 63 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se afatet e ankimit parashikuar nga neni 63 i LPP-së janë afate prekluzive. Këto afate, duke qenë afate prekluzive nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen. Për sa kohë që pala ankimuese nuk ka shteruar ankimin administrativ në shkallën e parë të ankimit parashikuar nga *lex specialis* pranë autoritetit kontraktor mbi pretendimin e mësipërm, e drejta e ankimit për to në një shkallë më të lartë (pranë Komisionit të Prokurimit Publik) ka rënë në dekadencë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi kryerjen e rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të ofertës teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat me argumentet se: “[...]”

lidhur me numrin e seteve dhe numrin e instrumentave në mënyrë absurde ne jemi vlerësuar me 0 (zero) pikë për numrin e seteve dhe me 0 (zero) pikë për numrin e instrumentave. Në bazë të dokumentit “projekti teknik” posaçërisht në faqen 128 dhe 180, si edhe në katalogun e instrumentave të prezantuar nga ne, janë dokumentuar të gjitha setet dhe instrumentat e kërkuara. Projekti jonë është unik dhe ka të detajuara të gjitha hapat për realizimin e kontratës ku demonstrojmë se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dhëna në dokumentat standarte të procedurës në lidhje me numrin e seteve dhe numrin e instrumentave. [...] Oferta jonë jep mundësinë e kompozimit të seteve kirurgjikalë në bazë të preferencave të vetë mjekëve kirurgë, praktikisht në miliona kombinime. Në përfundim, duke marrë shkas nga pika 2 e vlerësimit dhe gjendja faktike e ofertave të të dy ofertuesve, ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. ka ofruar në total 96,234 instrumenta duke u vlerësuar nga KVO me 14 pikë, ndërkohë që ne kemi ofruar rreth 100,000 instrumenta kirurgjikalë sipas llojit dhe metodologjisë dhe jemi vlerësuar me 0 pikë, gjë që duhet të ishte vlerësuar në kah të kundërt, përkatësisht 14 pikë për ne dhe 0 pikë për ofertuesin “Servizi Italia” s.p.a. Pretendimin tonë e bazojmë në dokumentacionin e paraqitur në procedurë ku skedat/listat jepen të ndarë për çdo kategori ndërhyrje kirurgjikale, gjë e cila është shumë e thjeshtë për t’u verifikuar pas një kontrolli më të kujdesshëm nga ana e KVO-së [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në seksionin IV.2 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme do të kryhet si më poshtë vijon:

“[...]”

<i>Numri i seteve kirurgjikale të ripërdorshëm ne dispozicion gjatë gjithë kohës.</i>	<i>14</i>
<i>Numri total i instrumenteve të ofruara.</i>	<i>14</i>
<i>Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat.</i>	<i>12</i>
<i>Koha e vënies në shfrytëzim</i>	<i>6</i>
<i>Ndikimi social dhe mjedisor</i>	<i>10</i>
<i>Çmimi për set instrumentesh për ndërhyrje me intensitet të lartë</i>	<i>7</i>
<i>Çmimi për set instrumentesh për ndërhyrje me intensitet të mesëm</i>	<i>7</i>

<i>Çmimi për Set instrumentesh për ndërhyrje me intensitet të ulët</i>	7
<i>Çmimi për Instrumente të sterilizuar për pacientet ambulatorore</i>	7
<i>Çmimi për Sterilizim në temperaturë te ulet.</i>	4
<i>Plani i riinvestimi ne makineri dhe pajisje dhe plani i mirëmbajtjes se instrumenteve kirurgjikale</i>	12

[...]"

III.2.2. Në Shtojcën 10 “ *Kriteret e Vlerësimit*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se:

“ [...] *Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pikë me tepër në bazë te kriterëve te vlerësimit. Komisioni do të vlerësoje Ofertat Teknike dhe Financiare, në bazë të kriterëve të mëposhtme*

<i>Nr</i>	<i>Kriteret</i>	<i>Vlera maksimale e pikëve për:</i>	<i>Vlerësimi në pikë</i>	
1	<i>Numri i seteve kirurgjikale të ripërdorshem në dispozicion gjatë gjithë kohës</i>	<i>Vlerën maksimale të kriterit.</i>	14	Pi=
2	<i>Numri total i instrumenteve të ofruara.</i>	<i>Vlerën maksimale të kriterit.</i>	14	

Elementët e formulave të llogaritjes:

Pi= Pikët e ofertuesit për kriterin

Ss = Numri i seteve kirurgjikale të ofruar

Smax = Numri maksimal i seteve të ofruar në garë

Ii = Numri i instrumenteve të ofertua Imax = Numri maksimal i instrumenteve të ofruara në garë.

Sp = Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferike të ofrura nga ofertuesi

Sp = Numri maksimal i pikave të mbulimit të shërbimit periferike

C_i = Çmimi i ofertuesit

C_{min} = Çmimi më i ulët i ofruar

T_i = Koha e vënies ë shfrytëzim e ofertuesit

T_{min} = Koha minimale e ofruar e vënies në shfrytëzim

[...]"

III.2.3. Autoriteti kontraktues në “Shpjeguesin e Kriterëve të Vlerësimit” të shtojcës 10 “Kriteret e Vlerësimit” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat ka sqaruar operatorët ekonomikë mbi metodologjinë e vlerësimit si më poshtë vijon:

“ [...] Shpjeguesi i kriterëve të vlerësimit

1- Numri i seteve kirurgjikale të ripërdorshim në dispozicion gjatë gjithë kohës, është kriteri i cili mat sasinë e seteve në sallat kirurgjikale dhe në urgjencat. Ofertuesi me numrin më të madh të seteve në dispozicion do të përfitojë pikët maksimale të kriterit.

o Tipologjia dhe kompozimi/konfigurimi i seteve kirurgjikale, duhet të jetë e përshtatur me kompozimin/konfigurimin e seteve kirurgjikale në shtojcën 20, ndërkohë që numri i seteve në kompleksitetin e vet duhet të përshtatet sipas tabelës nr. 1, e cila jep të dhëna mbi aktivitetin kirurgjikal spitalor sipas sasisë dhe llojit/tipologjisë të operacioneve. Është pikërisht tipologjia e ndërhyrjeve kirurgjikale që ka detyruar ndarjen sipas ndërhyrjeve me intensitet të ulët (psh. ndërhyrjet në otorinolaringologji), intensitet të mesëm (psh ndërhyrjet në kirurgjinë e përgjithshme), intensitet të lartë (psh.: kardiokirurgji, neurokirurgji, urologji) si dhe ndërhyrje ambulatorë psh mjekime plagësh, heqje thonjsh, trajtim furunkulash etj).

2- Numri total i instrumenteve të ofruara, është kriteri i cili mat numrin e instrumenteve kirurgjikale të propozuara në total për çdo lloj ndërhyrje. Ofertuesi me numrin më të madh të ofruar të instrumenteve kirurgjikale përfiton pikët maksimale të kriterit. [...]

**Oferta e paraqitur jo në përputhje me kriteret e lartpërmendura do të përbëjnë shkak për skualifikimin e ofertuesit. * Kriteret e paraqitura në Ofertë përbëjnë kushte të panegociueshem të Kontratës Konçesionare/ PPP dhe nuk mund të ndryshohen në asnjë rast.*

[...]"

III.2.4. Nga verifikimet e kryera të dokumenteve të dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së Koncesionit/partneritetit publik privat, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar:

1- Shtojca 4 “ Deklaratë mbi Investimet në Teknologji, Instrumenta Kirurgjikalë, Aksesorë dhe Logjistikë”

Lloji	i	Sasia	Modeli	Certifikatat	Investimi në Teknologji	Investimi në Teknologji
Teknologjisë						

				<i>për njësi</i>	<i>Total</i>
<i>1. Program Software dhe gjërmueshmëria në sallat kirurgjikale</i>	<i>1</i>	<i>Six Managmet</i>	<i>Specifikimet Teknike dhe certifikatat përkatëse gjenden bashkëlidhur në Projektin Teknik</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>
<i>2. Teknologji të tjera të ndryshme</i>	<i>4</i>	<i>Autoklavat me peroksid hidrogjeni (Sterrad)</i>	<i>Specifikimet Teknike dhe certifikatat përkatëse gjenden bashkëlidhur në Projektin Teknik</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>
<i>3. Investime Inovative për Instrumentat Kirurgjikale</i>	<i>-</i>		<i>Specifikimet Teknike dhe certifikatat përkatëse gjenden bashkëlidhur në Projektin Teknik</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>
<i>4. Aksesorë të tjerë</i>		<i>Sterilizimi dhe dizinfektimi i sallave kirurgjikale me ozon</i>	<i>Specifikimet Teknike dhe certifikatat përkatëse gjenden bashkëlidhur në Projektin Teknik</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>
<i>5. Impianti për trajtimin e mbetjeve spitalore</i>	<i>1</i>		<i>Specifikimet Teknike dhe certifikatat përkatëse gjenden bashkëlidhur në Projektin Teknik</i>		
<i>5. Mjete të shërbimit të logjistikës</i>			<i>Specifikimet Teknike dhe certifikatat përkatëse gjenden bashkëlidhur në Projektin Teknik</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>	<i>Sipas shtojcës 3-Plani vjetor i investimeve</i>

2. Projekti Teknik mbi “ Dhënieën me konçesion/partneritet publik privat të shërbimeve të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile,

furnizimin me material mjekësorë sterile njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”

3. Katalogët:

- i. Surgicon Diagnostic & Anaesthesia*
- ii. Surgicon Dressing & Tissue Forceps (1)*
- iii. Surgicon Dressing & Tissue Forceps (2)*
- iv. Surgicon Esophagoscopy Tracheotomy*
- v. Surgicon General Instruments*
- vi. Surgicon Holloware*
- vii. Surgicon Ophthalmology*
- viii. Surgicon Oral Instruments*
- ix. Surgicon Cardiovasculare Forceps*
- x. Surgicon Gynecology*
- xi. Surgicon Catalog me përshkrim (Instrumente Kirurgjikale (1))”*
- xii. Surgicon Catalog me përshkrim (Instrumente Kirurgjikale (7)*
- xiii. Surgicon Catalog me përshkrim (Instrumente Kirurgjikale) (pjesa 2))”*
- xiv. Katalog materialesh një përdorim*
- xv. Surgicon Orthopedic (1)*
- xvi. Surgicon Orthopedic (2)*
- xvii. Surgicon Retractors*
- xviii. Surgicon Rihnologt*
- xix. Surgicon Trocars*

III.2.5. Nëpërmjet shkresës nr. 1440/4 prot., datë 26.05.2015 “Kualifikim i Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi vlerësimin dhe metodologjinë e ndjekur. Në dërgimin e njoftimit mbi “Kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka vlerësuar ofertat si më poshtë vijon: “ Ky vlerësim është bazuar në metodologjinë e paraqitur në dokumentet e garës me argumentimin si më poshtë vijon:

- 1. Action Laundry nuk ka specifikuar numrin e seteve, përbërjen dhe kriteret e tyre, por ka prezantuar vetëm numrin e kontenierëve 1000 copë. Në këtë rast vlerësimi është me 0 pikë për Action Laundry.
Kompania Servizi Italia paraqet 2934 sete dhe çdo set ka kontenierë bashke me instrumentat e ofruar*
- 2. Kompania Servizi Italia ka paraqitur numrin total të instrumentave 96,2634 dhe vlerësohet me 14 pikë. Action Laundry nuk paraqet numrin total të instrumenteve të ofruar dhe do të vlerësohet me 0 pikë.*

III.2.6. Nga verifikimet e kryera të dokumenteve të dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së Koncesionit/partneritetit publik privat, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në asnjë rast të Propozimit Teknik të

dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues për procedurën e dhënies së koncesionit/ppp, objekt ankimi, operatori ekonomik ankimues nuk ka saktësuar numrin total të instrumentave kirurgjikalë të ofruar. Në kundërshtimet e ngritura mbi vlerësimin e bërë nga Komisioni i Dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik privat, si pranë autoritetit kontraktues, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pala ankimuese pretendon se: *[...]Në bazë të dokumentit “projekti teknik” posaçërisht në faqen 128 dhe 180, si edhe në katalogun e instrumentave të prezantuar nga ne, janë dokumentuar të gjitha setet dhe instrumentat e kërkuara.[...]*. Nga shqyrtimi i Projektit Teknik të dorëzuar nga pala ankimuese, “Kapitulli 5” me emërtim “Përshkrim i detajuar i aktivitetit të furnizimit me setet kirurgjikale e materialet njëpërdorim”, faqe 101 të projektit, pala ankimuese ka deklaruar se: “ *[...] Grupi ynë i përkoheshem i operatorëve ekonomik do të sigurojë që në të gjitha strukturat spitalore/ shëndetësore në territorin e Shqipërisë të kenë një gamë të instrumenteve kirurgjike specifike për çdo lloj ndërhyrjesh kirurgjikale, dhe është e angazhuar, që të propozojë për këto struktura, të gjitha mjetet, pajisjet dhe kështu me radhë, nga risitë shkencore dhe teknologjike të ofruara nga tregu europian dhe për gjithë kohëzgjatjen e kontratës [...]*”. Nga shqyrtimi i kryer i Projektit Teknik të dorëzuar nga pala ankimuese, rezulton se në faqen 128, paragrafi i fundit dhe faqe 129 paragrafi i parë i Projektit Teknik pala ankimuese ka parashikuar: “*[...]Bashkangjitur/shtojc keni dhe katalogun e artikujve të instrumentat kirurgjikale duke deklaruar se shtesa rezervë në materiale do jetë rreth 10-12 % e totalit të furnizimit për gjithë Shqipërinë, duke ju ritheksuar se kompozimi i këtyre seteve dhe futja e materialeve inovative do të jete për ne si Grup një mision dhe do të bëhen gjithmonë në bashkpunim me Përgjegjësit e sallave kirurgjikale dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu për çdo strument kirurgjikale o paisje të tjera inovative me shpenzimet tona do të kurse formimi/trajnimi për punonjësit tane dhe për personelin Tuaj në sallat kirurgjikale si dhe kurse trajnimi të veçanta për kirurgët dhe anestezistët tuaj.[...]*”. Ndërkohë nga verifikimi i pretendimeve të palës ankimuese se në faqen 180 të Projektit Teknik janë dokumentuar setet dhe instrumentat e kërkuar, rezulton se në “Kapitulli 6” “Plani i riinvestimit në teknologji instrumenteve kirurgjikalë, paisje dhe logjistikë”, të Projektit Teknik, faqe 180, pika 4 “Furnizimi Shtesë dhe rezervë në magazine” operatori ekonomik ankimues ka deklaruar se “ *Ashtu siç kemi deklaruar edhe në pikat e mësipërme të këtij projekti, duke marrë për bazë sa është deklaruar nga ana Juaj dhe duke parë gjatë shërbimit nevojat ditore të çdo salle kirurgjikale/ambulatoriale/ në rang Rrethi e Qarku ne do të krijojme magazina/depo në këto struktura duke i furnizuar me sete/kit strumntash dhe materile njëpërdorim (të gjitha nën kontrollin e rrept të skandencave me ndihmë e sistemit informatik dhe viziv të punonjësve tanë), për një sasi per 2 (dy) ditë pune aktive ose e marrë ndryshe në rreth 10% sasi. [...]*”

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat duhet të përgatisin ofertat e tyre financiare dhe teknike në përputhje me kërkesat e parashikuar nga autoriteti kontraktues në dokumentet e procedurës së koncesionit dhe partneriteti publik privat. Referuar “Kritereve të përzgjedhjes së fituesit”, shtojcës 10 “Kriteret e Vlerësimit” të dokumenteve

të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat, si edhe sqarimeve të bëra nga autoriteti kontraktues mbi kriteret e vlerësimit rezulton se operatorët ekonomikë kanë patur në dispozicion informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e hartimit të ofertave të tyre ekonomike dhe teknike. Vetë sistemi i pikëzimit dhe mënyra e përlllogaritjes së pikëve totale për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat parashikon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë në mënyrë të saktë numrin total të instrumenteve të ofruar. Deklarimi i numrit të saktë instrumenteve të ofruara në procedurën e mësipërme është një element kyç dhe i rëndësishëm jo vetëm për vlerësimin e propozimit teknik të ofruar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por gjithashtu edhe në vlerësimin me pikë të ofertuesve, si kriter i vetëm i përzgjedhjes së ofertës të suksesshme dhe fituese të procedurës së koncesionit/ppp. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se vetë operatori ekonomik ankimues nuk është i qartë dhe paraqet të dhëna konfuze mbi numrin e seteve të ofruara në procedurën e mësipërme, pasi në kundërshtimet mbi vlerësimin e Komisionit të Dhënies së Koncesionit dhe Partneritetit Publik Privat, pranë autoritetit kontraktues si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik deklaroi se ka ofruar *rreth 100,000 instrumenta kirurgjikalë*, si edhe faktin se *oferta jep mundësinë e kompozimit të seteve kirurgjikalë në bazë të preferencave të vetë mjekëve kirurgë, praktikisht në miliona kombinime*. Të ndodhur para kushteve të mësipërme, K.P.P gjykon se Komisioni i Dhënies së Koncesionit ka qenë në pamundësi të përcaktimit të numrit të saktë të totalit të instrumentave ofruar nga operatori ekonomik ankimues. Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se ka dorëzuar dy katalogë dhe se është detyrë e autoritetit kontraktues të kryejë numërimet e plota për të gjithë kombinimet nuk është i mbështetur. K.P.P gjykon se operatorët ekonomik janë të detyruar të përgatisin dokumentet e pjesëmarrjes në garën kocesionare/ppp në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues.

III.2.8. Në parashtrimet dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktues përmes shkresës 1440/22 prot., datë 29.07.2015, me objekt: *“Shkresë përcjellëse”* deklarohet se: *“Pretendimi i konkurrentit Action Laundry, në ankimin e tij se janë ofruar dy katalogë ku specifikohet rreth 4000 instrumente, tregon qartë se së pari bashkimi i përkohshëm i kryesuar nga Action Laundry nuk ka kuptuar që duhet të paraqesë setet e personalizuar (me instrumentat përkatës sipas çdo procedure kirurgjikale) duke mos lënë vend për evazivitet dhe së dyti, nuk mund të pretendojë operatori që KVO të numërojë vetë se sa instrumenta janë në katalogët e ofruar nga operatori dhe si ata kombinohen në sete të personalizuar, pasi në asnjë vend nuk përmendet numri i instrumentave nga ky operator”*.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Komisioni i Dhënies së Koncesionit/PPP të autoritetit kontraktues nuk ka patur asnjë të dhënë të deklaruar të drejtpërdrejtë, si referuar shtojcave të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, ashtu edhe referuar edhe Projektit Teknik dhe katalogëve të dorëzuar nga ky i fundit për përcaktimin e numrit të saktë të totalit të instrumentave të propozuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se edhe nga analizimi i detajuar i projektit teknik, analizuar në

veçanti secili kapitull i tij dhe në tërësi, nuk rezultojnë të dhëna teknike të cilat parashikojnë një numër të saktë të totalit të instrumenteve të ofruar nga operatori ekonomik ankimes.

III.2.9. Lidhur mbi pjesën e dytë të pretendimit të operatorit ekonomik ankimes, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi kryerjen e rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të ofertës teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat me argumentet se : “[...] Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. ka ofruar një 2934 sete kirurgjikale rezervë, ndërsa ne, kemi ofruar 10 % - 12 % të instrumenteve si fond rezervë, në bazë të ndërhyrjeve kirurgjikale që zhvillohen gjatë harkut kohor të një viti, që siç është parashtruar nga autoriteti kontraktor janë rreth 50.000 ndërhyrje kirurgjikale. Me anë të përlllogaritjes së thjesht matematikore ne kemi ofruar 5.000 – 6.000 sete kirurgjikale shtesë në vit. Pra rreth 2-3 herë më shumë se ofertuesi i vlerësuar i pari. Ajo çka ne mendojmë se duhet të ishte vlerësuar nga KVO përveç faktit që ne kalojmë dyfishin e sasisë së rezervës së ofruar nga ofertuesi tjetër, është fakti se oferta jonë është mbi bazë të ndërhyrjeve që do të realizohen duke ofruar mbulim të plotë të tyre edhe me rezervë. [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.9.1. Nëpërmjet shkresës nr. 1440/4 prot., datë 26.05.2015 “Kualifikim i Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi vlerësimin dhe metodologjinë e ndjekur. Në dërgimin e njoftimit mbi “Kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka vlerësuar ofertat si më poshtë vijon: “ Ky vlerësim është bazuar në metodologjinë e paraqitur në dokumentet e garës me argumentimin si më poshtë vijon:

1. Action Laundry nuk ka specifikuar numrin e seteve, përbërjen dhe kriteret e tyre, por ka prezantuar vetëm numrin e kontenierëve 1000 copë. Në këtë rast vlerësimi është me 0 pikë për Action Laundry.

Kompania Servizi Italia paraqet 2934 sete dhe çdo set ka kontenierë bashke me instrumentat e ofruar

III.2.9.2 Nga shqyrtimi i Projektit Teknik të dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik ankimes për procedurën e dhënies së koncesionit/ppp, objekt prokurimi, në faqen nr.128 ka deklaruar se: “Bashkangjitur/shtojc keni dhe katalogun e artikujve të instrumentat kirurgjikale duke deklaruar se shtesa rezervë ne materiale do jetë rreth 10-12 % e totalit të furnizimit për gjithë Shqipërinë”. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimes në përlllogaritjen e kryer (bazuar argumentave të dhënë si pranë autoritetit kontraktues dhe pranë K.P.P) i referohet numrit mesatar të ndërhyrjeve prej 50,000 të deklaruar nga autoriteti kontraktues në dokumentet e procedurës së koncesionit/ppp.

III.2.9.3. Në seksionin “Udhëzime mbi Ofertuesit”, pika 1, faqe 7, paragrafi 7 autoriteti kontraktues ka sqaruar operatorët ekonomikë se : “[...] Në total janë kryer afërsisht 25,100 operacione ne spitalet rajonale dhe universitare te tiranes dhe 22545 ne QSUT. Kjo shifër i referohet vitit 2013. Totali për gjithë Shqipërinë është rreth 50,000 nderhyrje kirurgjikale në vitin 2013 [...]” Gjithashtu në “Sqarimet mbi operatorët ekonomikë”, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga ana e autoritetit kontraktues, ky i fundit ka sqaruar se : “ [...] Numri i deklaruar prej 50,000 nderhyrjesh kirurgjikale, siç është paraqitur në Dokumentin e Tenderit (DT), i referohet ndërhyrjeve që janë kryer në spitalet rajonale dhe universitare, pa përmendur ndërhyrjet në spitalet bashkiake (të qyteteve të vogla). Gjithsesi për me shumë transparencë, tabela në vijim në DT, ka dhënë të gjitha ndërhyrjet kirurgjikale, siç janë deklaruar nga të gjitha spitalet ne Republikën e Shqipërisë. Në DT, kemi thënë që, projekti do të shtrihet në të gjitha spitalet universitare dhe rajonale të Shqipërisë, si dhe në spitalet e tjera sipas planit të racionalizimit spitalor që ka Ministria e Shëndetësisë, të hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore. Ky plan konsiston në ndryshimin e destinacionit të spitaleve të vogla bashkiake në Qendra Shëndetësore të rrjetit të shërbimit shëndetësor parësor dhe për rrjedhojë nuk do të ketë ndërhyrje kirurgjikale të planifikuara në këto spitale. Për rrjedhojë, ndërhyrjet kirurgjikale do të përqendrohen në spitalet universitare, rajonale dhe disa spitale të tjera që duhet të qëndrojnë si struktura spitalore për shkak te ngarkesës me popullate apo për shkak të sezonit turistik (Lushnjë, Kavajë, Sarandë, Pogradec, Bulqizë etj). [...]”

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se të dhënat e mësipërme të publikuar nga autoriteti kontraktues janë të dhëna statistikore, të cilat i referohen numrit total të ndërhyrjeve të kryera në vitin 2013 në të gjithë spitalet në Shqipëri, duke përfshirë spitalet rajonale dhe universitare të Tiranës, duke luajtur rolin e një të dhëne indikative për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/ppp objekt ankimi, e cila ndikon në krijimin e një panorame të përgjithshme të kushteve në të cilat “Koncesionari” do të ofrojë shërbimin e tij. Vetë autoriteti kontraktues në sqarimet e bëra për operatorët ekonomikë ka nënvizuar faktin se të dhënat e mësipërme janë statistikore dhe në asnjë rast me ndikim të drejtpërdrejtë në përgatitjen e ofertës teknike të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se të dhënat statistikore të një periudhe të caktuar të marrë në studim nga autoriteti kontraktues nuk mund të shërbejnë si bazë e përllogaritjeje mbi numrin e seteve dhe instrumenteve të ofruar nga operatorët ekonomikë në procedurën koncesionare/ppp objekt ankimi. Sistemi i pikëzimit dhe mënyra e përllogaritjes së pikëve totale për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/partneriteti publik privat parashikon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë në mënyrë të saktë numrin total të seteve të ofruar. Deklarimi i numrit të saktë të seteve kirurgjikale të ripërdorshëm në dispozicion gjatë gjithë kohës, në procedurën e mësipërme është një element kyç dhe i rëndësishëm jo vetëm për vlerësimin e propozimit teknik të ofruar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por gjithashtu edhe në vlerësimin me pikë të ofertuesve si kriter i vetëm i përzgjedhjes së ofertës të suksesshme dhe fituese të procedurës së koncesionit/ppp. Komisioni i Prokurimit Publik

gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka deklaruar një numër të saktë seteve të propozuar, por ka lënë një marzh prej 10-12 % e furnizimit vjetor të seteve, përlllogaritur mbi të dhëna statistikore të publikuara nga autoriteti kontraktues. K.P.P gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk qartëson numrin total të seteve të ofruar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat duhet të përgatisin ofertat e tyre financiare dhe teknike në përputhje me kërkesat e parashikuara nga autoriteti kontraktues në dokumentet e procedurës së dhënies së koncesionit dhe partneritetit publik privat. Referuar “*Kritereve të përzgjedhjes së fituesit*”, dhe Shtojcës 10 “*Kriteret e Vlerësimit*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat, si edhe sqarimeve të bëra nga autoriteti kontraktues mbi kriteret e vlerësimit, rezulton se operatorët ekonomikë kanë patur në dispozicion informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e hartimit të ofertave të tyre ekonomike dhe teknike.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.3. Lidhur mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi kryerjen e rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të ofertës teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat në lidhje me numrin e pikave të mbulimit të shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat me argumentet se “*[...] Interpretimi i KVO se shoqëria jonë ka vendosur vetëm 2 qendra periferike është i gabuar pasi siç edhe cituam më sipër shoqëria jonë ka vendosur 2 makro – qendra (së bashku me atë të ndodhur pranë QSUT 3), të cilat shërbejnë për prodhimin e seteve kirurgjikale, makroqendra këto të cilat kanë në varësi 28 qendra periferike të cilat shërbejnë për zhvillimin e shërbimit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, çka do të thotë se në total bëjnë 28 qendra, numër ky që matematikisht do të thotë 5 qendra më shumë se sa ofertuesi tjetër. [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në seksionin IV.2 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat, është parashikuar se vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme do të kryhet si më poshtë vijon:

“*[...]*”

<i>Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat.</i>	<i>12</i>
--	-----------

[...]”

III.3.2. Në Shtojcën 10 “ *Kriteret e Vlerësimit*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se:

“ [...] *Ofertat do të vlerësohen në bazë të kritereve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pikë më tepër në bazë të kritereve të vlerësimit. Komisioni do të vlerësojë Ofertat Teknike dhe Financiare, në bazë të kritereve të mëposhtme*

Nr	Kriteret	Vlera maksimale e pikëve për:	Vlerësimi në pikë
3	<i>Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat.</i>	<i>Vlerën maksimale të kriterit.</i>	12

Elementët e formulave të llogaritjes:

Pi= Pikët e ofertuesit për kriterin

Ss = Numri i seteve kirurgjikale të ofruar

Smax = Numri maksimal i seteve të ofruar në garë

Ii = Numri i instrumenteve të ofertua Imax = Numri maksimal i instrumenteve të ofruara në garë. 37

Sp = Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferike të ofrura nga ofertuesi

Sp = Numri maksimal i pikave të mbulimit të shërbimit periferike

Ci = Çmimi i ofertuesit

Cmin = Çmimi më i ulët i ofruar

Ti = Koha e vënies në shfrytëzim e ofertuesit

Tmin = Koha minimale e ofruar e vënies në shfrytëzim

[...]

III.3.3 Autoriteti kontraktues në “*Shpjeguesin e Kritereve të Vlerësimit*” të shtojcës 10 “*Kriteret e Vlerësimit*” të dokumenteve të garës së procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat ka sqaruar operatorët ekonomikë mbi metodologjinë e vlerësimit si më poshtë vijon: “[...] *Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat, është kriteri i cili mat numrin e qendrave të rezervës (backup) sa më pranë spitaleve që do të kryhet shërbimi për të qene në gatishmëri. Minimalisht çdo qendër duhet të përmbajë 1 autoklavë me avull dhe 1 larëse instrumentesh automatike. Ofertuesi i cili ofron numrin më të madh të qendrave rezerve përfiton pikët maksimale të kriterit [...]*”

III.3.4. Në Shtojcën 12 “*Specifikimet Teknike*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se:

“ [...] Qendra e sterilizimit periferike/apo qendrat e back up të projektit.

Aparaturat e procesit

a) Autoklava:

- kapacitet 4 njësi - avuj të vetegjeneruar - karrel dhe aksesore të tjerë. - me cikël të fraksionuar me kontroll elektronik - 220 V/380 V

b) Disinfektues termokimik për larjen e instrumenteve:

- kapacitet 10 njësi. - me karrelin dhe aksesorët.

c) Apartura të paralarjes dhe të dekontaminimit

- me cikël termokimik.

d) Pajisje për mbylljen sterile dhe hermetike të qeskave që do të përmbajnë setin kirurgjikal.

e) Pajisje për sterilizimin kimik me peroksid hidrogjeni.

f) Konteiner për sterilizim

- me përbërje alumini - përmasa të përshtatshme për të mbajtur setet kirurgjikale.

[...]”

III.3.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1440/4 prot., datë 26.05.2015 “Kualifikim i Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi vlerësimin dhe metodologjinë e ndjekur. Në dërgimin e njoftimit mbi “Kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka vlerësuar ofertat si më poshtë vijon: “ Ky vlerësim është bazuar në metodologjinë e paraqitur në dokumentet e garës me argumentimin si më poshtë vijon:

“ [...] Action Laundry ka paraqitur 2 qendra periferike të pasqyruara në faqen 178 tek projekti teknik dhe vlerësohet me 1.32 pikë.

Kompania Servizi Italia ka paraqitur 18 qendra periferike dhe vlerësohet me 12 pikë. [...]”

III.3.5. Nga shqyrtimi i Projektit Teknik të dorëzuar në S.P.E nga operatori ekonomik ankimes, “Kapitulli 6” “Plani i riinvestimit në teknologji instrumenteve kirurgjikalë, paisje dhe logjistike”, pika 2 “ Qendra periferike të sterilizimit në rrethe”, faqe 177 ka propozuar:

“[...] Grypi ynë mendon të krijojë dy qendra periferike autonome dhe ndihmese per rrethet e tjera. Dhe pikërisht :

Qytetin e Shkodrës, ku do të vendosen autoklavat me avull, paisjet për larjet automatike dhe mbi të gjitha si përmisim i shërbimit dhe autoklavat për sterilizimin me temperaturë të ulët. Në të njejtin qytet mendojme te ngrihet edhe një impiant nga partneri i Grupit tonë “Brema Ambiente” për përpunimin e mbeturinave të gjeneruar nga shërbimi ynë me copëtim termomekanik. Këto dy impiante që parashtruan dhe që do krijojnë në njëfarë mënyre dhe shkëputjen graduale nga vartesia e qendrës kryesore “Qendra e sterilizimit Nënë Tereza – Tiranë” do të ketë për mendimin tonë një impakt social “për shtesën në vendet e punës” por edhe një impakt i një organizimi autonom dhe i pavarur për gjithë zonën e Veriut të Shqipërisë. Ky projekt mendojmë të vihet në punë nga fundi i vitit të dytë nga data e fillimit të shërbimit tonë.

Qyteti i Fierit, edhe këtu duam të bëjmë të njëjtën gjë si me rastin e Shkodrës, duke menduar që në këtë mënyrë do jemi më afër edhe qyteteve të tjera të Jugut, por edhe pse nga statistikat që Ju na ofruat është një ndër qytetet e jugut me numrin më të madh për ndërhyrje kirurgjikale vjetore.

*Një pikë e rëndësishme që për ne: **Zonat Turistike.** Mendojmë Vlorën, Sarandën, Pogradecin, Durrësin ku për gjithë sezonin veror që për ne fillon nga 15 Maj e deri në fund të Shtatorit, do ti japim përparësi dhe furnizime shtesë dhe një frekuencë më të madhe me mjetet tona të tonazhit të vogël drejt këtyre zonave, duke menduar se po vijmë drejt një periudhe ku do ketë dundje turistësh të huaj e vendas dhe duam të japim maksimumin me imazhin dhe shërbimin tonë.*

Një pikë me shumë interes dhe e dobishme për ne do të jenë dhe magazinat/depot periferike që duam të ngrejmë në disa rrethe të Shqipërisë me materialet njëpërdorim e materiale të tjera të konsumit (detergjent..etj..) për të qenë sa më afër për një furnizim të shpejt zonave të paracaktuara gjeografike.

Ngelet të shtojmë që çdo lëvizje në përzgjedhjen e pikave periferike të sterilizimit dhe mënyrën e shërbimit që ne duam të bëjmë ne zonat turistike të Shqipërisë do të vendosen bashkarisht me Përgjegjësit Tuaj [...]"

III.3.6. Nga shqyrtimi i Projektit Teknik të propozuar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka propozuar krijimin e dy qendrave periferike për mbulimin e shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat (back up). Në Projektin Teknik *Kapitulli 6*, "*Plani i riinvestimit në teknologji instrumenteve kirurgjikale, paisje dhe logjistike*", pika 2 "*Qendra periferike të sterilizimit në rrethe*", faqe 177, operatori ekonomik ankimues ka deklaruar në mënyrë eksplicite që në rast të fitimit të kontratës së koncesionit/ppp objekt ankimi, "*Koncesionari*" do të krijojë dy qendra periferike për mbulimin e shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat, e cila në terminologjinë e përcaktuar nga autoriteti kontraktues në dokumentet e procedurës së dhënies së koncesionit/ppp njihen ndryshe si qendra "*back up*". Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se këto dy qendra të propozuara nga pala ankimuese (një në qytetin e Shkodrës, si qendër "*back up*" për zonën e veriut dhe një në qytetin e Fierit si qendër "*back up*" për zonën e jugut (referuar ndarjes së bërë nga ofertuesi), rezultojnë si qendra të ndara nga qendra kryesore (baza) e instaluar pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se "*[...]Theksojmë se në varësi të këtyre 2 makro qendrave janë 23 qendra të tjera periferike, praktikisht për çdo spital të cilat shërbejnë për zhvillimin e shërbimit siç edhe specifikohet dhe kërkohet nga autoriteti kontraktor. [...]"*, nuk gjen mbështetje dhe provueshmëri në propozimin teknik (Projektin Teknik) të propozuar nga ky i fundit. Nga shqyrtimi i Projektit Teknik të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit në asnjë rast nuk ka parashikuar krijimin e qendrave të "*back up*", pranë spitaleve rajonale në të gjithë vendin referuar pretendimeve paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe K.P.P mbi kundërshimet e vlerësimit teknik të bërë nga Komisioni i Dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat. Në Projektin Teknik "*Kapitulli 5*"

“Përshkrimi i detajuar i aktivitetit të furnizimit me setet kirurgjikale materialet njëpërdorim” faqe 131, *“Rezervat e Materialeve Njëpërdorim”*, operatori ekonomik ankimues ka propozuar *“[...] Në mënyrë që të sigurohet menaxhim i lehtë dhe organizim rreth dërgesave të drejtpërdrejta nëpër spitale të ndryshme/salla kirurgjikale/ambulatoriale, NE kemi si qëllim për të krijuar dy depo të decentralizuara : njëri i cili do të gjendet në qytetin e Shkodrës, dhe do të na lejojë për të menaxhuar të gjithë dërgesat e spitaleve në veri; dhe një tjetër në qytetin e Fierit, i cili do të na lejojë të menaxhojmë të gjitha furnizimet për spitalet në jug. Brenda këtyre dy pikave, gjithashtu do të vendosen rezervat në materiale të barabarta për mbulimin e dy ditëve të punës . E njëjta bazë e barabartë me dy ditëve të punës do të jetë e garantuar edhe në magazinat e brendshme në sallat kirurgjikale të çdo spitali, në mënyrë që të mos ketë mungesë materilesh për asnjë arsye edhe në raste emergjente. [...]”*. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik në mënyrë eksplicite ka vlerësuar se ka qëllim të krijojë dy qendra periferike të *“back up”* dhe se në spitalet rajonale do të vendosen rezerva të mjaftueshme në magazinat e brendshme të sallave kirurgjikale. Në dokumentet e procedurës së dhënies së koncesionit/ppp objekt ankimi, autoriteti kontraktues i ka dhënë një pozitë të veçantë qendrave të *“back up”* duke parashikuar minimumin e karakteristikave teknike që do të ketë secila qendër (aparaturat e nevojshme dhe proceset që do të kryhen në këto qendra) duke i veçuar nga spitalet rajonale në të cilat do të kryhet furnizimi me paisjet mjekësore objekt i procedurës së koncesionit/ppp. Vetë operatori ekonomik ankimues është i paqartë në lidhje me numrin total të qendrave të *“back up”* të propozuara, pasi në kundërshtimet pranë autoritetit kontraktues ngren pretendimin se ky i fundit ka propozuar 25 qendra *“back up”*, ndërkohë në kundërshtimet pranë K.P.P ngren pretendimin se ka propozuar krijimin e 28 qendrave *“back up”*. Në lidhje me propozimin e bërë nga operatori ekonomik ankimues në Propozimin Teknik të këtij të fundit mbi krijimin e qendrave të *“back up”* provizore gjatë sezonit turistik, K.P.P konstaton se në pretendimet e ngritura pranë autoritetit kontraktues dhe pranë K.P.P, pala ankimuese në asnjë rast nuk ka pretenduar në llogaritjen e numrit të qendrave të *“back up”* të llogariten edhe qendrat provizore (të propozuara për t’u ngritur gjatë sezonit turistik).

III.3.7. Për shkak se metodologjia e vlerësimit të ofertës teknike të operatorit ekonomik ankimues në procedurën e dhënies së koncesionit/ppp lidhet drejtpërdrejtë edhe me ofertën teknike të operatorëve tjerë pjesëmarrës, si edhe për shkak se operatori ekonomik ankimues ngre pretendime mbi përlllogaritjen në vlerësimin e ofertës teknike në lidhje me kriterin e mësipërm edhe të qendrës bazë pranë QSUT si qendër *“back up”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga shqyrtimi i Propozimit Teknik të operatorit tjetër ekonomik pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/ppp, bashkimit të operatorëve ekonomikë *“Investital”* Llc. & *“Servizi Italia”* S.p.a. & *“Tecnosanimed”* & *“U.Jet”* S.r.l, rezulton se në kapitullin 7 *“Plan Zbatim i Projektit të Logjistikës”*, faqe 6, është propozuar edhe shpërndarja e qendrave të *“back up”* në të gjithë Shqipërinë. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se propozimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë kryesuar nga *“Servizi Italia”,s.p.a* në lidhje me qendrat e *“back up”* është prezantuar nëpërmjet hartës së

Republikës së Shqipërisë dhe vendosjes në hartë përmes simboleve vendodhjen e qendrave të “back up”. Referuar legjendës së hartës, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga bashkimi i operatorëve ekonomikë kryesuar nga “Servizi Italia”, është propozuar 1 qendër bazë në Qytetin e Tiranës dhe 17 qendra “back up” dhe si më poshtë vijon:

1. Një qendër “back up” në qytetin e Bajram Currit
2. Një qendër “back up” në qytetin e Shkodrës
3. Një qendër “back up” në qytetin e Kukësit
4. Një qendër “back up” në qytetin e Lezhës
5. Një qendër “back up” në qytetin e Burrelit
6. Një qendër “back up” në qytetin e Bulqizës
7. Një qendër “back up” në qytetin e Durrësit
8. Një qendër “back up” në qytetin e Elbasanit
9. Një qendër “back up” në qytetin e Librazhdit
10. Një qendër “back up” në qytetin e Pogradecit
11. Një qendër “back up” në qytetin e Korçës
12. Një qendër “back up” në qytetin e Lushnjës
13. Një qendër “back up” në qytetin e Fierit
14. Një qendër “back up” në qytetin e Beratit
15. Një qendër “back up” në qytetin e Vlorës
16. Një qendër “back up” në qytetin e Gjirokastrës
17. Një qendër “back up” në qytetin e Sarandës

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktues në përlllogaritjen e numrit total të qendrave të “back up” të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Investital” Llc. & “Servizi Italia” S.p.a. & “Tecnosanimed” & “U.Jet” S.r.l., përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a ka llogaritur 18 (qendra) duke përfshirë edhe qendrën bazë të sterilizimit vendosur pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë. Gjithashtu, nga shqyrtimi i projektit teknik të këtij bashkimi operatorësh në kapitullin 7 “Plan Zbatim i Projektit të Logjistikës”, faqe 5, ka propozuar edhe krijimin e një qendre në rolin e shpërndarjes *transit point* “ [...]Për shpërndarjen/dorezimin e materialeve në spitalet periferike, parashikojmë krijimin e një transit-point se bashku me skortat e kiteve të instrumentave kirurgjikale dhe të materialit kirurgjikale një perdorimsh (WNW - Woven Non Woven).[...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për vetë faktin e pozitës së veçantë që ka parashikuar autoriteti kontraktues të qendrave të “back up”, qendra e propozuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a., nuk mund të konsiderohet si qendër “back up”. Mbi të gjitha në projektin teknik të këtij bashkimi operatorësh, këta të fundit kanë saktësuar vendodhjen e saktë të qendrave të “back up”, gjithësej shtatëmbëdhjetë (17). Në rast se autoriteti kontraktues ka përlllogaritur dhe vlerëson se qendra bazë e propozuar për t’u ngritur pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë (Q.S.U.T) konsiderohet edhe si qendër “back up”, për bashkimin e operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga “Servizi Italia”, në respekt të parimit të trajtimit të

barabartë të ofertuesve, parashikuar si një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të dhënies së koncesioneve/ppp nga *lex specialis*, ligji 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, atëherë në përlllogaritjen mbi numrin total të qendrave të “back up” të operatorit ekonomik ankimues “Action Laundry” sh.p.k duhet të përfshijë edhe qendrën bazë të propozuar pranë Q.S.U.T , parashikuar në Projektin Teknik të këtij të fundit (faqe 12 e vijues të Projektit Teknik). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se parimi i trajtimit të barabartë të ofertuesve, krahas të tjerave parashikon trajtimin e njëjtë të ofertuesve për situata të njëjta. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues pjesërisht qendron. Autoriteti Kontraktues duhet të rivlerësojë procedurën e dhënies së koncesionit/ppp, objekt ankimi në drejtim të pikëve të dhëna operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me pikën 3 të Kriterëve të Vlerësimit, parashikuar në Shtojcën 10 “Kriteret e Vlerësimit”, “Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat”, duke vlerësuar si qendër “back up” edhe qendrën bazë (pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”) të propozuar nga operatori ekonomik ankimues ose duke vlerësuar ofertat referuar sistemit të pikëzimit me shtatëmbëdhjetë (17) qendra “back up”, propozuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese pjesërisht qëndron.

III.4. Lidhur mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi kryerjen e rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të ofertës teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat në lidhje kohën e vënies në shfrytëzim të projektit me argumentet se “ [...]Në DST kërkohet që projekti të zbatohet brenda afatit 60 ditor dhe në këtë kuptim ofertuesit që respektojnë afatin 60 ditor duhet të vlerësohen me pikët maksimale prej 6 pikë. Në fakt në mënyrë të gabuar KVO-ja na ka vlerësuar ne me 6 pikë dhe ka zbatuar koeficientin për ofertuesin tjetër duke e vlerësuar në mënyrë të gabuar me 4.98 pikë. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në seksionin IV.2 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme do të kryhet si më poshtë vijon:

“[...]”

Koha e vënies në shfrytëzim	6
-----------------------------	---

“[...]”

III.4.2. Në Shtojcën 10 “ *Kriteret e Vlerësimit*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se:

“ [...] *Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pike më tepër në bazë të kriterëve të vlerësimit. Komisioni do të vlerësojë Ofertat Teknike dhe Financiare, në bazë të kriterëve të mëposhtme*

Nr	Kriteret	Vlera maksimale e pikëve për:	Vlerësimi në pikë
4	Koha e vënies në shfrytëzim	Vlerën maksimale të kriterit.	6

Elementet e formulave të llogaritjes:

Pi = Pikët e ofertuesit për kriterin

Ss = Numri i seteve kirurgjikale të ofruar

Smax = Numri maksimal i seteve të ofruar në garë

Ii = Numri i instrumenteve të ofertua Imax = Numri maksimal i instrumenteve të ofruara në garë.

Sp = Numri i pikave të mbulimit të shërbimit periferike të ofrura nga ofertuesi

Sp = Numri maksimal i pikave të mbulimit të shërbimit periferike

Ci = Çmimi i ofertuesit

Cmin = Çmimi më i ulët i ofruar

Ti = Koha e vënies në shfrytëzim e ofertuesit

Tmin = Koha minimale e ofruar e vënies në shfrytëzim

[...]

III.4.3 Autoriteti kontraktues në “*Shpjeguesin e Kriterëve të Vlerësimit*” të shtojcës 10 “*Kriteret e Vlerësimit*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat ka sqaruar operatorët ekonomikë mbi metodologjinë e vlerësimit si më poshtë vijon: “[...] *Koha e Vënies në Shfrytëzim: është kriteri që vlerëson kohën minimale të ofruar për vënien në funksion të shërbimit. Afati maksimal për kryerjen e këtij shërbimi është 60 dite nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Ofertuesi me kohën më të shkurtër do të përfitojë maksimumin e pikëve [...]*”.

III.4.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1440/4 prot., datë 26.05.2015 “*Kualifikim i Operatorëve Ekonomikë*”, autoriteti kontraktues ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi vlerësimin dhe metodologjinë e ndjekur. Në dërgimin e njoftimit mbi “*Kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë*”, autoriteti kontraktues ka vlerësuar ofertat si më poshtë vijon: “ *Ky vlerësim është bazuar në metodologjinë e paraqitur në dokumentet e garës me argumentimin si më poshtë vijon:*

“ [...] Action Laundry e ka paraqitur kohën e vënies në shfrytëzim 50 ditë dhe vlerësohet me 6 pikë.

Servizi Italia e ka paraqitur e ka paraqitur kohën e vënies në shfrytëzim 60 ditë dhe vlerësohet me 4.98 pikë [...]”

III.4.5. Nga shqyrtimi i Projektit Teknik të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së Koncesionit/partneritetit publik privat, nga operatori ekonomik ankimues në “Kapitulli 1” “Përshkrimi i Projektit, të Dhënat Teknike të Projektit dhe Realizimi i Tij”, faqe 2 është propozuar: “[...]Grupi ynë i përkohëshëm i operatoreve ekonomik deklaron që, në rast të dhënies së shërbimit, kohën e nevojshme për zbatimin e shërbimit në të gjitha pjesët e saj është llogaritur në një interval kohor që varion nga 23 (njetëzetë tre) ditë deri në 1 (një) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës: kohë e nevojshme për blerjen e të gjitha materialeve (të instrumenteve kirurgjikale, materiale njëpërdorim, aksesoreve, kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave ... etj) , të nevojshme për fillimin e kontratës në fjalë. [...]”

III.4.6. Në parashtrimet dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktues përmes shkresës 1440/22 prot., datë 29.07.2015, me objekt: “Shkresë përcjellëse” deklarohet se “ [...]Përsa i përket kontestimit në kohën e zbatimit të projektit komisioni ka vlerësuar në mënyrë shumë të matur diskordancën e të dhënave në faqen 2 të kapitullit 1 të projektit teknik dhe grafikun funksional të zbatimit në faqen 11 të kapitullit 2 të projektit teknik, ku vërehet që “faktori kohë” për aktivizimin e shërbimit pranë QSUT Tiranë është 50 ditë.[...]”.

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në vlerësimin e bërë nga Komisioni i Dhënies së Koncesionit/ppp, të ofertës teknike të palës ankimuese, mbi kriterin e mësipërm, rezulton se autoriteti kontraktues i është referuar “Kapitulli 2” “Grafiku funksional dhe Zbatimi”, faqe 11 të Projektit Teknik të ankimuesit. Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në faqen 11 të Projektit Teknik të ankimuesit, rezulton se ky i fundit ka parashikuar: “[...]Më poshtë kemi krijuar një grafik nga aktivitetet që do të kryhen gjatë kohëzgjatjes së kontratës në fjalë, ku në veçanti, kemi marrë parasysh faktorin kohë dhe tërësinë e aktiviteteve që do të kryhen [...]”. Konstatohet se grafiku i paraqitur nga pala ankimuese është një grafik i tipit diagram me shtylla të dyfishta. Në grafikun e paraqitur në projektin teknik të operatorit ekonomik ankimues rezulton se grafiku është i përbërë nga dy boshte, boshti horizontal dhe vertikal dhe njëzetë kollona (dhjetë kolona dyfishe) përbërës të grafikut, të ilustruara me dy ngjyra të ndryshme të dallueshme nga njëra tjetra. Në boshtin horizontal të grafikut paraqitet njësia e matjes periudha kohore e ndarë në vite duke nisur nga viti 1 (i parë) deri në vitin 9 (e nëntë), ndërsa në boshtin vertikal paraqitet një sistem numërimi duke nisur nga numri zero me progresivitet rritës me distancë 5 dhe përfunduar në numrin 50 (pesëdhjetë) (0,5,10,15....50). Gjithashtu konstatohet se në boshtin vertikal të grafikut nuk janë përcaktuar të dhënat e nevojshme për interpretimin e tij siç është njësia e matjes, por vetëm të dhënat numerike (të dhënat e variablave). Gjithashtu nga analizimi në

tërësi të grafikut dhe të elementëve spjegues të tij në asnjë rast nuk konstatohen të dhëna të qarta mbi njësinë e matjes së të dhënave vendosur në boshtin vertikal të grafikut të paraqitur në faqen 11 të Projektit Teknik të operatorit ekonomik ankimues.

III.4.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktues nuk ka vlerësuar drejt propozimin teknik të operatorit ekonomik ankimues. Vlerësimi i bërë nga autoriteti kontraktues për periudhën e vënies në shfrytëzim të projektit duke marrë si njësi matëse të boshtit vertikal të grafikut – njësi matëse ditë të paraqitur në faqen 11 të Projektit Teknik të palës ankimuese, ku në asnjë rast në grafikun e mësipërm nuk përcaktohet njësi matëse, është e gabuar. Autoriteti Kontraktues në vlerësimin e ofertave teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë të dhënies së koncesionit/ppp duhet të lexojë me kujdes të dhënat e propozuara dhe në asnjë rast të përdorë interpretime jo të bazuara në fakt të këtyre të dhënave. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për shkak të mangësisë së konstatuar në të dhënat e mësipërme të grafikut bëhet i pamundur interpretimi i tij e për rrjedhojë pretendimi i autoritetit kontraktues se në vlerësimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit janë marrë për bazë të dhënat e grafikut të sipër përmendur nuk qëndron. Nga ana tjetër K.P.P gjykon se operatori ekonomik ankimues në Projektin Teknik të dorëzuar në procedurën e dhënies së koncesionit/ppp ka parashikuar si afat maksimal të vënies në shfrytëzim të projektit të propozuar një periudhë kohore midis njëzetë e tre (23) ditë deri në një muaj (30 ditë), kjo e bërë përmes një deklaratë të shprehur qartësisht në faqen 2 të projektit.

Autoriteti Kontraktues duhet të rivlerësojë procedurën e dhënies së koncesionit/ppp, objekt ankimi në drejtim të pikëve të dhëna operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me pikën 4 të Kriterëve të Vlerësimit, parashikuar në Shtojcën 10 “*Kriteret e Vlerësimit*” “*Koha e vënies në shfrytëzim*”, duke kryer rivlerësim në bazë të konstatimit të mësipërm.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.5. Lidhur mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi s’kualifikimin e bashkimi të operatorëve ekonomikë “Investital” Llc. & “Servizi Italia” S.p.a. & “Tecnosanimed” & “U.Jet” S.r.l., përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a me pretendimin se anëtar i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” s.p.a nuk plotëson kapacitetin ligjor me argumentet se “*[...]Referuar pikës 3 të shtojcës 9 “Kriteret e përgjithshme për kualifikim”, ofertuesi duhet të dorëzonte pranë autoritetit vërtetimin QKR (vërtetim nga regjistri tregtar), të cilin vërtet e ka depozituar, por objekti i koncesionit nuk është i parashikuar në objektin e aktivitetit të kësaj shoqërie (referuar ekstraktit të shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a.), gjë që është shkak për skualifikim. (kualifikimi e bën procedurën të bazohet mbi një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1 Në Shtojcën 9, pika 3 “*Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit*”, të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është kërkuar:

“[...] 3. *Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këto kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të leshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. [...]*”

Në Shtojcën 9, pika 2 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.1 “*Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë*”, të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është kërkuar:

“[...] 2.1. *Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë,*

1. *Rregjistrimi si person juridik. Ekstrakt i regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;*

2. *NUIS; [...]*”

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së Koncesionit/partneritetit publik privat objekt ankimi, bashkimi i operatorëve ekonomikë kryesuar nga shoqëria “*Servizi Italia*” s.p.a kanë dorëzuar Kontratën e Bashkimit të Përkoshëm të Shoqërive hartuar para një noteri publik në Republikën e Shqipërisë, hartuar në gjuhën shqipe dhe italiane, Nr. 598 Rep dhe Nr.187 Kol datë 04.03.2015 përmes të cilës është krijuar Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “*Investital*” Llc. & “*Servizi Italia*” S.p.a. & “*Tecnosanimed*” & “*U.Jet*” S.r.l., përfaqësuar nga “*Servizi Italia*” s.p.a me qëllim marrjen pjesë në procedurën e dhënies së koncesionit/ppp (referuar nenit 1 të kontratës “*Objekti i BSHP*”), procedurë objekt ankimi. Në nenin 5 “*Detyrimet e anëtarëve të BPSH*”, pika 5.2 e kontratës së bashkëpunimit, parashikohet se:

“[...] *Anëtarët marrin përsipër të realizojnë detyrat që kanë në ngarkim, siç përcaktohet në vijim. Ky detyrim shtrihet edhe mbi të gjithë punët ndihmëse e të nevojshme për realizimin e detyrimeve të ndërmarra nga Anëtarët në lidhje me këtë Kontratë:*

-Servizi Italia do të kryejë shërbimin e furnizimit të setit të instrumentave kirurgjikalë sipas përcaktimeve të kocensionit. [...]”

III.5.3. Për plotësimin e kriterit të parashikuar në Shtojcën 9, pika 3 “*Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit*” dhe në Shtojcën 9, pika 2 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.1 “*Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë*”, anëtari i bashkimit të

operatorëve ekonomikë “Investital” Llc. & “Servizi Italia” S.p.a. & “Tecnosanimed” & “U.Jet” S.r.l., “Servizi Italia” s.p.a ka dorëzuar:

- i. Certifikatë Regjistrimi në Seksionin e Zakonshëm Nr. Prot. CEW/234/2015/CPR0077 lëshuar nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Artizanatit Bujqësisë të Parmës e legalizuar me vulë apostile dhe e përkthyer në gjuhën shqipe e noterizuar nga noteri publik në Republikën e Shqipërisë.

III.5.4. Nga shqyrtimi i Certifikatës së Regjistrimit të anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Servizi Italia” s.p.a, rezulton se në seksionin: “Objekti i Veprimtarisë” në gërmën:

- i. “C” parashikohet si objekt veprimtarie i shoqërisë: *“Zhvillim Prodhim dhe Furnizim të Paisjeve Mjekësore të përbëra nga sete sterile për salla operacioni, të përbëra nga pëlhura dhe këmisha të ripërdorshme në pambuk dhe fibra të tjera; Sterilizim të strumenteve kirurgjikalë sterilizim dhe dorëzim të produkteve sterile në qendrat e përdorimit.”;*
- ii. “D” parashikohet si objekt veprimtarie i shoqërisë: *“Blerja, ndërmjetësimi, shitja prodhimi dhe zhvillim i paisjeve mjekësore me mundësinë për të ofruar dhe furnizuar shërbime të mbështetjes teknike për drejtimin e furnizimeve që kanë për objekt paisjet mjekësore.”;*
- iii. “F” parashikohet si objekt veprimtarie i shoqërisë : *“Transporte të brendshme të spitaleve”;*
- iv. “G” parashikohet si objekt veprimtarie i shoqërisë: *“Aktivitet llogjistik, drejtim magazinash, transport dhe shpërndarje të produkteve”;*
- v. “H” parashikohet si objekt veprimtarie i shoqërisë: *“Menaxhim i shërbimeve të menaxhimit të zyrave të shoqërive shëndetësore dhe spitalore”;*
- vi. “J” parashikohet si objekt veprimtarie i shoqërisë: *“Termo-Shkatërrimi i mbetjeve, menaxhimi dhe mirëmbajtja e impianteve termike”*

Gjithashtu në objektin e veprimtarisë së shoqërisë, referuar Certifikatës së Regjistrimit parashikohet edhe: *“[...] Gjithashtu shoqëria mund të marrë pjesë në shoqata të përkohshme të ndërmarrjeve të parashikuara nga ligji për furnizimin publik dhe për shërbimet publike; Gjithashtu mund të marrë pjesë në konsorcio dhe në aktivitete të jashtëm sipas nenit 2062 dhe në vijim të Kodit Civil. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në territorin kombëtar dhe ndërkombëtar, si në fushën e bashkësisë dhe jashtëbashkësisë, me mundësinë për të krijuar, ndryshuar dhe mbyllë filiale, degë, agjenci ose njësi lokale sido të quajtura. [...]”*

III.5.5. Në pikën 1,2,3 dhe 6 të nenit 25 “Bashkimi i Përkohshëm i Shoqëtive” të VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat” parashikohet:

“[...]”

1. Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm. Në rast të bashkimit të grupeve të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktues duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.
2. Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.
3. Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.
6. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. “Kërkesat ekonomike,financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”

III.5.6. Sa më sipër, konstatohet se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a., ka si objekt të veprimtarisë së saj pasqyruar edhe në regjistrin tregëtar të lëshuar nga shteti ku shoqëria është regjistruar, veprimtari të tilla si: “Zhvillim Prodhim dhe Furnizim të Paisjeve Mjekësore të përbëra nga sete sterile për salla operacioni, të përbëra nga pëlhura dhe këmisha të ripërdorshme në pambuk dhe fibra të tjera; Sterilizim të strumenteve kirurgjikalë sterilizim dhe dorëzim të produkteve sterile në qendrat e përdorimit.” “Blerja, ndërmjetësimi, shitja prodhimi dhe zhvillim i paisjeve mjekësore me mundësinë për të ofruar dhe furnizuar shërbime të mbështetjes teknike për drejtimin e furnizimeve që kanë për objekt paisjet mjekësore”, të cilat janë në përputhje me elementët konkretë të shërbimit që shoqëria ka marrë përsipër të kryejë si anëtare e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë referuar kontratës të Nr. 598 Rep dhe Nr.187 Kol datë 04.03.2015 në përputhje me parashikimet e aktit normativ në zbatim nenit 25 pika 3 të VKM 575 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a. përmbush kriteret kriteret e parashikuara në shtojcën 9, pika 3 të “Kritereve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit” dhe në shtojcën 9, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1 “Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë”.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.6. Lidhur mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliermo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi s’kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Investital” Llc. & “Servizi Italia” S.p.a. & “Tecnosanimed” & “U.Jet” S.r.l., përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a me pretendimin se

[...]Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së instrumenteve kirurgjikale. Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk ka ofruar shërbimin e mirëmbajtjes së makinerive/autoklavave për sterilizimin e materialeve. Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. Nuk ka ofruar shërbimin e pastrimit, dezinfektimit të ambienteve të qendrës së terilizimit. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në seksionin IV.2 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme do të kryhet si më poshtë vijon:

[...]

<i>Plani i riinvestimi ne makineri dhe pajisje dhe plani i mirëmbajtjes se instrumenteve kirurgjikale</i>	12
---	-----------

[...]”

III.6.2. Në Shtojcën 10 “Kriteret e Vlerësimit” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është parashikuar se:

“ [...] Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pike më tepër në bazë të kriterëve të vlerësimit. Komisioni do të vlerësojë Ofertat Teknike dhe Financiare, në bazë të kriterëve të mëposhtme

Nr	Kriteret	Vlera maksimale e pikëve për:	Vlerësimi në pikë
7	<i>Plani i riinvestimit në teknologji, instrumenta dhe plani i mirëmbajtjes së instrumenteve kirurgjikale.</i>	-	12

[...]”

III.6.3. Autoriteti kontraktues në “Shpjeguesin e Kriterëve të Vlerësimit” të shtojcës 10 “Kriteret e Vlerësimit” të dokumenteve të garës së procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat ka sqaruar operatorët ekonomikë mbi metodologjinë e vlerësimit si më poshtë vijon:

7- *Plani i riinvestimit në teknologji dhe instrumenta dhe plani i mirëmbajtjes së instrumenteve kirurgjikale: është kriteri që përcakton planin duke përfshirë vlerën e riinvestimit në makineri e pajisje dhe instrumentet kirurgjikale të nevojshme për kryerjen e*

shërbimit brenda 3 viteve të fundit e shprehur në lekë. Ofertuesi që paraqet planin me përshtatshëm të riinvestimit dhe mirëmbajtjes do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

III.6.4. Në Shtojcën 9, pika “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika, 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është kërkuar:

*“[...] Plani i ri-investimit në teknologji, instrumenta kirurgjikale, aksesore të projektit, logjistike. Plani logjistik i zbatimit të projektit. Në këtë plan duhet të përshkruhen në menyrë të detajuar plani i administrimit dhe menaxhimit të stacionit qendror të Sterilizimit ne QSUT** (Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza, Tirane), plani për furnizimin e sallave kirurgjikale me setin e instrumentave sterile, materialet mjeksore njëpërdorimëshe (veshjet), plani për mbledhjen, lëvizjen, grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve me rrisht biologjik, planin për dezinfektimin e ambjentëve ku do të ofrohet shërbimi në këtë projekt, planin e lëvizjes së materialeve të pista dhe atyre të pastra. [...]”*

III.6.3. Në seksionin “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, faqe 13 paragrafi i fundit të dokumentave të dhënies së koncesionit/ppp, objekt ankimi, është parashikuar: *“[...] Përveç të tjerave ofertuesi duhet të sigurojë një plan të mirëorganizuar të mirëmbajtjes së stacionit qendror të sterilizimit në QSUT, pajisjeve të sterilizimit, të sigurojë burimet e furnizimit të përhershëm me to dhe të garantojë asistencë teknike në kohën e duhur. [...]”*

III.6.4. Përmes shkresës nr. 1440/4 prot., datë 26.05.2015 “Kualifikim i Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi vlerësimin dhe metodologjinë e ndjekur. Në dërgimin e njoftimit mbi “Kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë”, autoriteti kontraktues ka vlerësuar ofertat si më poshtë vijon: *“ Ky vlerësim është bazuar në metodologjinë e paraqitur në dokumentet e garës me argumentimin si më poshtë vijon:*

“ [...] Përsa i përket planit të riinvestimit ofertuesit kanë paraqitur oferta e tyre si më poshtë:

Action Laundry- 89,869,400 Lekë

Servizi Italia 2,008,984,000 Lekë

Sipas metodologjisë së vlerësimit në pikën 7, Servizi Italia vlerësohet me 12 pikë kurse Action Laundry me 0.51 pikë [...]”

III.6.5. Nga shqyrtimi i Projektit Teknik të dorëzuar të dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së Koncesionit/partneritetit publik privat, bashkimi i operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a., rezulton se në kapitullin 7 dhe në kapitullin 8 janë parashikuar në mënyrë të detajuar ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së instrumenteve kirurgjikale, i mirëmbajtjes së makinerive/autoklavave për sterilizimin e materialeve, dizinfektimit të mjediseve sëbashku me të gjithë proceset e punës dhe parametrat teknikë të detajuar të ofrimit të shërbimeve të

sipërcituara. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në projektin teknik të propozuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a., është parashikuar në mënyrë të detajuar procesi i dizinfektimit të mjediseve, mjediseve spitalore, paisjeve të veçanta, automjeteve të cilat shërbejnë për shpërndarjen e materialeve mjekësore (seteve kirurgjikale objekt furnizimi), etj. Gjithashtu konstatohet se procesi i shërbimit të pastrimit dhe të dizinfektimit të qendrës së sterilizimit, të propozuar në projektin teknik të bashkimit të operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a., lidhet drejtpërdrejtë me proceset e punës dhe të mirëmbajtjes në tërësi të instrumentave kirurgjikalë si edhe të makinerive/autoklavave të qendrës së sterilizimit (qendrës bazë) si edhe pikave të mbulimit të shërbimit periferik rajonal për rezervat dhe urgjencat, njohur ndryshe si “*back up*”. Gjithashtu rezulton se në projektin teknik janë detajuar në mënyrë të hollësishme proceset e punës lidhur me shërbimin e dizinfektimit, llojit të materialit dizinfektues, teknologjinë e propozuar për t’u përdorur etj., Nga shqyrtimi në detaje të projektit teknik, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë kryesuar nga “Servizi Italia” s.p.a., ka parashikuar në mënyrë të detajuar mirëmbajtjen dhe riinvestimin si në drejtim të aparaturave të qendrave të sterilizimit ashtu edhe të vetë instrumenteve mjekësorë objekt furnizimi. Konstatohet se në “*Kapitullin 8*” “*Plani i mirëmbajtjes së paisjeve teknologjike dhe instrumentave kirurgjikalë të furnizuara për shërbimin e koncesionit*” të Projektit Teknik, pika 8.2 është parashikuar procesi i mirëmbajtjes së Qendrës së Sterilizimit (QSUT) si edhe vendodhjet periferike të *back up-ëve*. Akoma më tej në pikën 8.3 të Kapitullit 8 të Projektit Teknik, është parashikuar *mirëmbajtja e impianteve* si edhe proceset e punës dhe skemat teknike të ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes për impiantet: fluidomekanikë; impianteve elektrikë; impianti i zbulimit të zjarrit. Në lidhje mbi parashikimin e mirëmbajtjes së instrumentave kirurgjikalë rezulton se në projektin teknik të bashkimit të operatorëve ekonomikë të përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a., është parashikuar pika 8.5 “*Mirëmbajtja e instrumentave kirurgjikalë*” të Kapitullit 8, në të cilin janë parashikuar në mënyrë të detajuar proceset e punës të mirëmbajtjes së instrumentave kirurgjikalë si edhe të zëvendësimit të tyre.

Sa më sipër pretendimet e palës ankimese nuk qëndrojnë.

III.7. Lidhur mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k mbi s’kualifikimin e bashkimi të operatorëve ekonomikë “Investital” Llc. & “Servizi Italia” S.p.a. & “Tecnosanimed” & “U.Jet” S.r.l., përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a me argumentet se “*[...]Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk është i licencuar për të ofruar shërbimet e parashtruara në këtë koncension në shtetet extra/EU dhe se Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk disponon licencën e kërkuar për trajtimin e mbetjeve spitalore. [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1 Në Shtojcën 9, pika “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika, 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është kërkuar:

“[...] Ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij;

Lejet dhe licencat e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit sipas objektit të kontratës së koncesionit / partneritetit publik privat. ISO 9001, ISO 13485, CERTIFIKATE CE (42/93) ose ekuivalente. [...]”

III.7.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së Koncesionit/partneritetit publik privat, për plotësimin e kriterit të mësipërm, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Servizi Italia” s.p.a. ka dorëzuar:

- i. Certifikatë nr.0560/5 UNI EN ISO 9001:2008 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” e legalizuar me vulë apostile, e përkthyer në gjuhën shqipe e noterizuar nga noteri publik në Republikën e Shqipërisë me anë të cilës vërtetohet se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a është e certifikuar konform standardit UNI EN ISO 9001:2008 për ushtrimin e aktivitetit me objekt “*Projektim dhe ofrimi i shërbimeve të integruara të qiramarrjes rikondicionim (dizinfektim,larje,përfundim) dhe logjistikë të artikujve tekstilë të njëpërdorshëm. DPI (paisje personale mbrojtëse). Dyshekë. Menaxhim i veshjeve spitalore. Projektim dhe ofrimi i shërbimeve të integruara të qiramarrjes rikondicionim (dizinfektim,larje,përfundim) dhe logjistikës të paisjeve sterilë për çarçafët e sallave të operacionit dhe veshjeve me materiale teknike të ripërdorshme (TTR)- Intrumente operatore të ripërdorshme dhe aksesore të paisjeve sterilë të perdeve prej pambuku dhe veshje. Furnizim i paisjeve një përdorimshme. Tregëtim i paisjeve shëndetësore. DPI-paisje mjekësore njëpërdorimshme dhe të ripërdorshme sterile apo jo,të seteve proceduralë për ndërhyrje kirurgjikale.Projektim,instalim,rinovim dhe menaxhim i impianteve të lavanderisë dhe sterilizimit. Rekuperim funksional i ambienteve të lavanderisë dhe dhomave të veshjeve.*”
- ii. Certifikatë nr.1107/3 UNI CEI EN ISO 13485:2012“Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” e legalizuar me vulë apostile, e përkthyer në gjuhën shqipe e noterizuar nga noteri publik në Republikën e Shqipërisë me anë të cilës vërtetohet se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a është e certifikuar konform standardit UNI CEI EN ISO 13485:2012 për ushtrimin e aktivitetit me objekt: “[...]Projektim dhe ofrimi i shërbimeve të integruara të qiramarrjes rikondicionim (dizinfektim,larje,përfundim) dhe logjistikës të paisjeve sterilë për çarçafët e sallave të operacionit dhe veshjeve me materiale teknike të ripërdorshme (TTR) Intrumente operatore të ripërdorshme dhe aksesore të paisjeve sterilë të perdeve prej pambuku dhe veshje. Tregëtim i paisjeve të kuadrit shëndetësor. DPI-paisje mjekësore njëpërdorimshme dhe të ripërdorshme sterile apo jo,të seteve proceduralë për ndërhyrje kirurgjikale.

iii. Certifikatë nr.QPS-0484-14, lëshuar nga Instituti i Lartë i Shëndetit, “Për Miratimin e Sistemit të Garancisë për Cilësinë e Prodhimit dhe/ose Sterilizimit” e legalizuar me vulë apostile, e përkthyer në gjuhën shqipe e noterizuar nga noteri publik në Republikën e Shqipërisë me anë të cilës vërtetohet se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a është e certifikuar konform standardit 93/42/C CE për ushtrimin e aktivitetit për paisjet: “MDS 7011-Sete Kirurgjikale Sterile”

III.7.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së Koncesionit/partneritetit publik privat, bashkimi i operatorëve ekonomikë kryesuar nga shoqëria “Servizi Italia” s.p.a ka dorëzuar Kontratën e hartuar para një noteri publik në Republikën e Shqipërisë, hartuar në gjuhën shqipe dhe italiane, Nr. 598 Rep dhe Nr.187 Kol datë 04.03.2015 përmes të cilës është krijuar Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Investital” Llc. & “Servizi Italia” S.p.a. & “Tecnosanimed” & “U.Jet” S.r.l., përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a me qëllim marrjen pjesë në procedurën e dhënies së koncesionit/ppp (referuar nenit 1 të kontratës “Objekti i BSHP”), procedurë objekt ankimi. Në nenin 5 “Detyrimet e anëtarëve të BPSH”, pika 5.2 e kontratës së bashkëpunimit, parashikohet se:

“[...] Anëtarët marrin përsipër të realizojnë detyrat që kanë në ngarkim, siç përcaktohet në vijim. Ky detyrim shtrihet edhe mbi të gjithë punët ndihmëse e të nevojshme për realizimin e detyrimeve të ndërmarra nga Anëtarët në lidhje me këtë Kontratë:

-Servizi Italia do të kryejë shërbimin e furnizimit të setit të instrumentave kirurgjikalë sipas përcaktimeve të kocesionit. [...]”

III.7.4. Në pikën 1,2,3 dhe 6 të nenit 25 “Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive” të VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat,” parashikohet:

“[...]”

1. Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm. Në rast të bashkimit të grupeve të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktues duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

2. Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

3. Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

6. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. “Kërkesat ekonomike,financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i

marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë/shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”

III.7.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a., përmbush kriteret teknike të parashkuar në Shtojcën 9, pika “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika, 2.3 “*Kapaciteti teknik*” të dokumenteve të procedurës së dhënies së koncesionit/ppp objekt ankimi, në drejtim të paisjes me licencat përkatëse të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhje me elementët konkretë të shërbimit që shoqëria ka marrë përsipër të kryejë si anëtare e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë referuar kontratës të Nr. 598 Rep dhe Nr.187 Kol datë 04.03.2015 në përputhje me parashikimet e aktit normativ në zbatim të ligjit, nenit 25 pika 3 të VKM 575 datë 10.07.2013 “*Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat*”. Në lidhje me pretendimet e palës ankimuese se shoqëria “Servizi Italia” s.p.a nuk disponon licencat e nevojshme për të ofruar shërbimet e parashtruara në këtë koncesion në shtetet extra/EU, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në asnjë rast në dokumentet e procedurës për dhënien e koncesionit/ppp objekt ankimi nukë është parashikuar dorëzimi i licencave për ofrimin e shërbimit në shtet extra/EU, siç pretendohet nga operatori ekonomik ankimues. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ofertat ekonomike dhe teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e dhënies së koncesionit/ppp do të vlerësohen vetëm në bazë të kriterëve të vendosura në dokumentet e procedurës dhe në asnjë rast mbi kriteret të pa parashikuara në respekt të parimit të trajtimit të barabartë të ofertuesve parashikuar nga neni 9 i *lex specialis* ligji 125/2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*”.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.7.6. Lidhur mbi pjesën e dytë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë. mbi s’kualifikimin e bashkimi të operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga “Servizi Italia” s.p.a me argumentet se “*[...]Ofertuesi “Servizi Italia” s.p.a. nuk disponon licencën e kërkuar për trajtimin e mbetjeve spitalore. [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pretendimi i mësipërm i ngritur nga pala ankimuese është një pretendim i ngritur vetëm në ankesën dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe për të nuk është shteruar ankimi në fazë të parë pranë autoritetit kontraktor.

III.7.7. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit. Në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë

ankimuesit, ky i fundit nuk është ankuar lidhur me pretendimin e mësipërm pranë autoritetit kontraktor.

III.7.8. Në nenin 43 *“Procedura administrative dhe hetimi administrativ”* i ligjit 125/2013 datë 25.04.2013 *“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”*, i ndryshuar parashikohet se: *“Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë procedurat administrative të shqyrtimit dhe procedurat e hetimit administrativ, zbatohen në përputhje me rrethanat për dhënien e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të parashikuara me këtë ligj.* Në nenin 63 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se afatet e ankimit parashikuar nga neni 63 i LPP-së janë afate prekluzive. Këto afate, duke qenë afate prekluzive nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen. Për sa kohë që pala ankimuese nuk ka shteruar ankimin administrativ në shkallën e parë të ankimit parashikuar nga *lex specialis* pranë autoritetit kontraktor mbi pretendimin e mësipërm, e drejta e ankimit për to në një shkallë më të lartë (pranë Komisionit të Prokurimit Publik) ka rënë në dekadencë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk merret në shqyrtim.

III.8. Në respekt të parimit të transparencës dhe barazisë si dy ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së dhënies së koncesionit/ppp, parashikuar nga neni 9 i Ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 *“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e dhënies së koncesionit/ppp objekt ankimi, në shkresën nr. 1440/4 prot., datë 26.05.2015 *“Kualifikim i Operatorëve Ekonomikë”*, përmes të cilit autoriteti ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi vlerësimin dhe metodologjinë e ndjekur, autoriteti kontraktor ka gabuar në mbledhjen aritmetike të pikëve në total dhënë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për procedurën e mësipërme. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktues në rivlerësimin e procedurës duhet të kryejë edhe mbledhjen e saktë aritmetike të pikëve dhënë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 43, të Ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 *“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”* nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k. për procedurën e dhënies së koncesionit/partneriteti publik privat “Procedurë e Hapur”, me objekt: *“Ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale dhe ambjenteve ku do të ofrohet ky shërbim, në spitalet universitare dhe rajonale të vendit, apo dhe spitale të tjerë, sipas planit të racionalizimit spitalor në Republikën e Shqipërisë”*, me vlerë totale 9.657.000.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.05.2015, nga autoriteti kontraktues, Ministria e Shëndetësisë.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktues brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Action Laundry” sh.p.k., si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Action Laundry” sh.p.k. & “S.S.I.” sh.p.k. & “Mario Gugliemo” sh.p.k. & “Brema Ambiente” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1140 Protokoli, Datë 22.06.2015

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri